



ALUMNI JOURNAL

SUCCEED WITH QUALITY

MAJ 2016

Alumni, vlerë e përhershme e UBT-së

Celebrating



15 YEARS

Në këtë numër:

Editoriali	3
Rektori Edmond Hajrizi flet për studimet gjatë vitit akademik 2015-16.....	4-5
Nga konferenca “Dita austriake-kosovare e integrimi evropiane”.....	6
Nga UBT në City University.....	7
Ndërlidhja e studimeve me punën solli rezultatin e duhur... ..	7
Diploma e UBT-së njihet ndërkombëtarisht.....	8
Gjatë studimeve kam arritur t’i kuptoj të gjitha konceptet ekonomike.....	8
Ish-studenti i UBT-së digjitalizon pajisjet e vjetra industriale.....	8
Studentja e gjithanshme e Sistemeve të Informacionit.....	9
Kur sheh programet e UBT-së, e heq dilemën ku do të studiosh	10
Nga UBT në “Dessau Institute of Architecture” në Gjermani.....	10
Në UBT është një staf me performancë të lartë profesionale e akademike	10
I diplomuari i UBT-së, asistent i matematikës dhe pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme.....	11
Projektet e ish-studentit të UBT-së përdoren në tërë tregun e Kosovës.....	11
UBT-ja hap udhë për studime pasuniversitare në Evropë.....	11
Studimet në UBT, garanci për sukses.....	12
Ish- student i UBT-së shfaq aftësitë profesionale në Zvicër.....	12
Të diplomuarit në UBT me rrugë të hapura studimi e punësimi.....	12
UBT ofron shumë mundësi.....	13
Përkushtimi i UBT-së – avancimi i të rinjve për treg të punës.....	13
Studentët e UBT-së prezantuan 17 biznes-plane.....	14-15
Biblioteka Mjekësore dhe e Shkencave të Jetës në UBT pasurohet me 20 mijë libra të rinj.....	14-15
Kosova përballet me probleme të theksuara në fushën e strehimit.....	16-17
Bachelor dhe master në UBT, më është përshtatur shumë.....	18
Studentja e UBT-së, pjesë e shumë kompanive dhe zyrave projektuese.....	18
Studimi në UBT, pjesë e suksesit	18
Udhëtimi studimor në Evropë, një përvojë e paharrueshme.....	19
UBT më cilësori në Kosovë	19
UBT më ka ofruar intership në shumë kompani.....	20
Programi, profesorët dhe përkushtimi i madh – çelës i suksesit.....	20
Studimet në UBT të mundësojnë të përfitosh njohuri të shumta.....	20
Ish-studenti i UBT-së me performancë të lartë në tregun e punës.....	21
Projektet e studentëve të UBT-së mbërrijnë në vendet evropiane.....	21
Universiteti amerikan ofron mundësi të mëdha për studentët e UBT-së.....	22-23
Studentët: Studimi në UBT është privilegj	24-25
Studentja e arkitekturës, me firmë të vetën projektuese	26
UBT ka arritur t’i përmbushë kërkesat e mia për shkollim.....	26
Ish-studenti i UBT-së, arkitekt në MadenGroup.....	27
Student, këngëtar dhe menaxher i suksesshëm.....	27
UBT ofron ndihmë edhe për menaxhim të kompanive.....	27
Nga UBT në Fakultetin “Politecnico Di Milano”.....	28
Me punë, vullnet dhe pozitivitet arrihet çdo gjë.....	28
Realizova ëndrrën për t’u bërë arkitekte.....	28
Disa këshilla për të ndihmuar në luftën kundër ndryshimeve klimatike.....	29
Fotoreportazh.....	30-31

Impresum

UBT Alumni

Botues: Edmond Hajrizi

Redaksia: Albina Zeneli, Besarta Breznica, Besart Troshupa, Donis Zhugolli, Edona Jerliu, Fatbardha Kiqina, Fjolla Selmani, Ilaz Luzha, Leotrim Canaj, Sherife Sokoli.

Dizajni: Trimor Racaj

www.ubt-uni.net

Editorial

Alumni, vlerë e përhershme e UBT-së

Dr. Edmond Hajrizi

Revista “Alumni”, një nga shumë pikat që na mbajnë të bashkuar me alumnin e UBT-së, është sërish para jush. Sjell rrëfimet për Agonin, Albesën, Anesën, Arbërin, Almën, Ardonitën, Arianin, Bajramin, Besimin, Blinin, Dodonën, Doruntinën, Egzonin, Dukagjinin, Erduanin, Fatjonën, Fionën, Fitonin, Fjollën, Leartën, Marigonën, Kushtrimin, Meritonin, Nazyfin, Qëndresën, Rrezonin, Shpendin, Shqiprimin, Viganin e Zanën... Disa nga 247 studentët tanë që diplomuan në vitin 2015. Disa mbaruan studimet themelore dhe vazhdojnë të jenë pjesë e UBT-së në studimet master, të tjerë vazhdojnë studimet në nivele më të larta, të tjerë drejtojnë biznese të rëndësishme, kanë pozita të larta në institucione, e kanë nisur mbarë karrierën e tyre. Përmes faqeve të revistës, po edhe në forma të tjera ne jemi bashkë. Sepse bashkë na lidhin vitet që ju kaluat në UBT. Vite të gjata, me sfida e angazhime, por vite tepër të rëndësishme, që i dhanë drejtim të ardhmes suaj. Vite që ju lidhën përjetësisht me UBT-në, institucionin që do t’ju mbajë gjithmonë pranë, pavarësisht ku jeni, me emocionet e studimeve, me përkrahjen e vazhdueshme, kurdo që ju keni nevojë.

UBT këtë vit mbush 15 vjet punë. Në shikim të parë, nuk duken shumë. Por, që janë shumë për një institucion të ri, të krijuar në vitin 2001, të zhvilluar që nga ideja, të futur në radhë me konkurrencën e fuqishme, të përballur me të gjitha zhvillimet dhe ngjarjet e këtij pesëmbëdhjetëvjetëshi, një zë të fuqishëm në mbrojtjen e arsimit të lartë nga të gjitha zhvillimet që e rrezikuan atë, gjatë gjithë kohës.

Sot, falë këmbëngulësisë për të pasur si udhërrëfyes cilësinë, UBT është në vendin që është synuar që në nismë – institucioni i arsimit të lartë më i kërkuar nga të rinjtë nga Kosova e rajoni, me drejtimet më atraktive të studimit, me profesorët më eminentë, me hapësira moderne për studime, me laboratorë modernë në të gjitha fushat, me bibliotekën më të madhe në rajon...

Mbi të gjitha – me Alumnin më të suksesshëm, të pranishëm në institucionet më të mira botërore duke vazhduar doktoratat e profesionalizimet e tjera, ekspertë më të kërkuar në tregun e punës në Kosovë e jashtë saj, drejtues të suksesshëm, profesionistë të dalluar. Me Alumnin që, me vetë faktin se kanë studiuar në UBT, kanë një përparësi shumë të madhe në çdo garë konkurrence me kolegët e tjerë. Me Alumnin që në start të çdo gare është një hap përpara të tjerëve, sepse për tre apo pesë vjet në UBT ka bërë hapa shtesë dhe ka marrë dije e përvojë të të njëjtit nivel me universitetet më të rëndësishme evropiane. E lehtë dhe e thjeshtë – sepse UBT ka marrëveshje me dhjetëra universitete nga shtete të ndryshme. Ka sjellë në vend përvojën e tyre, por edhe programet, përvojën, profesorët nga këto universitete. Gjithashtu, ka krijuar mundësi për studentët e vet që të vijojnë studimet në to, duke parë nga afër përvoja e mundësi të reja.

Marrëveshjet ndërkombëtare, por edhe anëtarësimet e UBT-së në institucione të rëndësishme akademike e profesionale, janë një atu shtesë, një element të cilin të tjerët nuk e kanë, një mundësi unike për studentët e UBT-së. Ju e dini se UBT u mundëson vazhdim të studimeve jashtë vendit dhe kthim sërish në shtëpinë tuaj, në UBT, me tituj akademikë, për ta përcjellë dijen dhe përvojën te studentët e rinj. Ju e dini se të qenit pjesë e UBT-së krijon mundësi për të përfituar nga programet për përkrahjen e punës akademike dhe hulumtimeve shkencore nga institucionet kryesore të Bashkimit Evropian dhe nga mekanizmat e tjerë më të rëndësishëm në fushën e arsimit dhe të shkencës. E në shumicën prej tyre, UBT është përfituesi i vetëm nga Kosova, shpesh edhe nga rajoni.

Një arsye më shumë për t’u ndjerë krenar që je pjesë e UBT-së. Dhe për ta bartur me vete, kudo që shkon pas studimeve, dijen, përvojën, profesionalizmin, vullën e të qenit pjesë e institucionit që është këtu, në Prishtinë, në Republikën e Kosovës, që nga viti 2001. Institucionit që është pikë reference për të gjitha institucionet ndërkombëtare, akademike dhe të tjera, që është adresë e shumëkërkuar nga të rinjtë e të rejat e vendit, që nisin rishtas studimet e tyre, mikpritës i figurave të rëndësishme nga të gjitha fushat, ndërkombëtarë e vendorë, shtëpi e dytë e të gjithë dijetarëve e ekspertëve të rinj, të cilët e kanë prapa UBT-në, kudo ku shkojnë pas studimeve. Sepse, UBT i përcjell, i përkrah dhe ju gjendet pranë gjithmonë atyre që ishin pjesë e tij. Pasi, suksesi i secilit anëtar të Alumnit të UBT-së është edhe i yni.

Të qenit pjesë e UBT-së është privilegj, që ju bën ndryshe nga të tjerët, të veçantë dhe të suksesshëm, gjithmonë dhe kudo ku jeni. ■

UBT - 15 vjet rrëfim sukcesi

“Kosova dhe arsimiti i lartë në Kosovë është në fazën e ndërkombëtarizimit, prandaj për ne është shumë i rëndësishëm aspekti i ndërkombëtarizimit të UBT-së. Ne kemi një rezultat të mirë tek kjo pjesë, sepse kemi bashkëpunime të shumta me të gjitha vendet e zhvilluara të botës nga Evropa, e SHBA-ja”, thotë rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi në një intervistë për “Radio Kampus” dhe “UBT News”, ka folur për 15 vjet të UBT-së

si rrëfim sukcesi, për stafin prej 400 ligjëruesve dhe më shumë se 9 mijë studentëve. Në intervistë, profesor Hajrizi ka folur edhe për nevojën e dinamizimit të kërkimeve shkencore, si nga studentët ashtu edhe nga stafi akademik, për ndërlidhjet dhe shkëmbimin e përvojave të UBT-së me universitetet e tjera me traditë evropiane, për nevojën e zgjerimit të UBT-së me programe të reja, për pjekjen e kushteve që edhe në UBT të fillojnë programet e doktoratës...

UBT News: Si kaloi semestri i parë akademik gjatë këtij viti?

Hajrizi: Mendoj se semestri dimëror ka qenë një pjesë e vitit të ri akademik që ka shënuar rezultate sikurse edhe semestrat tjerë të viteve të kaluara. Kemi pasur më shumë studentë, staf e infrastrukturë. Ka pasur rezultate të mira, duke u bazuar në faktin që studentët tanë kanë shfaqur rezultate të mira, e suksese të shumta, si: bursa për studime në universitetet e tjera, ku ata kanë shfaqur rezultate pozitive në punët e tyre praktike, duke u angazhuar në problemet që ka pasur Google, pastaj në vizitat e bëra në vende të ndryshme, e që kanë dalë si rezultat i punëve dhe sukseseve që ata kanë arritur. 40 studentë të UBT-së, pas një ftese nga ekspertë të ndërmarrësisë, për t'i përfshirë në një institucion të kësaj natyre, të gjithë e kanë plotësuar kriterin, që ishte befasi edhe për hartuesit e kriterëve, të cilët mbase kanë pritur që do të ketë më pak, kurse ne kemi qenë akoma më të lumtur për faktin se studentët tanë po bazohen në vlera, po punojnë dhe në këtë mënyrë po shkohet më tutje, prandaj mund të përfundojmë që ka qenë një semestër shumë i suksesshëm.

UBT News: Keni pasur vizita të shpeshta në shtetet evropiane, a mund të tregoni se cilat janë përvojat që i keni marrë nga atje, ose çfarë përvojash keni dërguar?

Hajrizi: Kosova dhe arsimiti i lartë në Kosovë është në fazën e ndërkombëtarizimit, prandaj për ne është shumë i rëndësishëm aspekti i ndërkombëtarizimit të UBT-së. Ne kemi një rezultat të mirë tek kjo pjesë, sepse kemi bashkëpunime të shumta me të gjitha vendet e zhvilluara të botës nga Evropa, e SHBA-ja. Nga ky rrjet i tërë bashkëpunimi na bie të kemi vizita të shumta për të rritur bashkëpunimin, pastaj për të krijuar bashkëpunime të reja dhe për t'i intensifikuar ato, por edhe për të gjeneruar projekte e ide të reja bashkëpunimi. Aktualisht jemi fokusuar tek vendet e Vishegradit, si: Çekia, Sllovakia, Hungaria, e Polonia, që edhe atje të krijohen bashkëpunime të shumta. Kemi pasur vizita të shumta në Universitetin e Budapestit, të Varshavës, e të Bratisllavës. Kemi qenë si profesorë-vizitorë, kemi shkëmbyer studentë dhe staf, si dhe kemi nënshkruar marrëveshje për diploma të përbashkëta. Kështu, është krijuar një rrjet i gjerë i mundësive për studentët që të vazhdojnë të kenë bursa, si dhe për stafin që të kenë përvoja të reja me kolegë të tjerë dhe për këtë arsye është dashur që të vizitohen vende të ndryshme.

UBT News: Dy javët e fundit janë karakterizuar me organizime të përbashkëta: UBT – Shoqata Austriake-Kosovare. Këto zhvillime, pothuajse, kanë qenë në fokus të opinionit publik, prandaj a mund të flisni pak se si keni arritur të ndërtoni raporte kaq të ngushta me strukturat akademike, shtetërore e të shoqërisë civile të Austrisë?

Hajrizi: Unë kam kryer studimet në Austri, si dhe kam punuar atje dhe Austria ka qenë njëra ndër pikënisjet e ndërmarrësisë së UBT-së dhe përkrahëse e madhe në këtë aspekt. Në këtë përkrahje kanë marrë pjesë profesorë e ekspertë, të cilët i kanë kontribuar krijimit, ndërtimit, e zhvillimit të UBT-së. Ne kemi një raport të veçantë me Austrinë dhe me Shoqatën Austriake-Kosovare, ku unë jam udhëheqës i bordit këshillëdhënës të kësaj shoqate. Kështu, jemi marrë vesh që bashkërisht të krijojmë evente që kanë për qëllim njoftimin me modelet dhe praktikatat e mira austriake, por edhe me temat që janë të nevojshme për zhvillimin e Kosovës. Duke filluar nga viti i kaluar, ne organizojmë konferencat njëditore, të ashtuquajtura “Ditët austriake-kosovare”, për fusha të ndryshme. Kështu, kemi organizuar ditën e mediave, të integritimit evropian, të sigurisë, atë të turizmit, të qeverisjes lokale etj. Në përgjithësi, prekim tema të rëndësishme, ku ftojmë ekspertë të jashtëm, kryesisht nga Austria, por edhe nga vende të tjera, ekspertë vendorë, palë të interesit, e qeveritarë, kurse debatojmë për tema me rëndësi për Kosovën, për atë se ku jemi, e ku duhet të shkojmë dhe cilat janë praktikatat e mira për zbatim dhe prej te cilave kemi përfitime.



Prof. dr. Edmond Hajrizi: “UBT-ja është pikë reference pozitive dhe është shembull i liderit në aspektin e arsimit të lartë në regjionin e Ballkanit Perëndimor”

UBT News: A do të vazhdoni me organizime të tilla dhe cilat janë synimet tuaja kryesore që dëshironi t'i arrini duke sjellë ekspertiza e përvoja për fusha të ndryshme?

Hajrizi: UBT-ja është forum ku të gjithë mund të vijnë e të shprehën si dhe të paraqesin pikëpamjet e tyre të pavarura dhe intelektuale. Ideja dhe qëllimi kryesor është që të ftohen personalitete të tilla si Busek, Lunachek, ministra të punëve të jashtme të vendeve të ndryshme, ministrat tanë, të cilët japin kontribut të madh në këtë pjesë. Është shumë e rëndësishme që të bëhet një dialog i mirëfilltë mes pjesës politikëbërëse dhe shoqërisë, kurse universiteti ynë shërben si urë lidhëse dhe është vendi ku debatohet, prandaj kjo na nderon, por edhe na jep përgjegjësi për krijimin e forumeve të mëtutjeshme.

UBT News: Profesor Hajrizi, sot ka filluar semestri i dytë i vitit akademik 2015/2016, çka u sugjeroni studentëve, profesorëve dhe të gjithë të angazhuarve të tjerë Brenda UBT-së?

Hajrizi: Ideja jonë është që të bazohemi në cilësi e saktësi të të gjithë kuadrit, të tregojmë se përmes një studimi cilësor mund të arrihen rezultate të mira në jetë, mund të ndërtohet karrierë, vende pune, mund të ndihmohet shoqëria etj. Përgjegjësia e studentit është që të studiojë seriozisht, të shtrojë pyetje, t'i marrë informacionet e duhura, të jetë proaktiv, të marrë pjesë në ligjërata e të punojë projekte. Kurse, përgjegjësia më e madhe bie mbi stafin akademik i UBT-së, në mënyrë që t'i ndihmojë studentëve të rinj që kanë nevojë më së shumti për orientim profesional, të bazuar në argumentet dhe praktikatat më të mira. Ky angazhim po vazhdon nga ky grup i ekspertëve që tash jemi mbi 400 dhe punojmë me më tepër se 9000 studentë. Në këtë mënyrë po krijohet një sistem dhe bashkëpunim interesant, me një potencial pozitiv për zhvillimin e Kosovës. Prandaj, kjo është një ndjenjë e përgjegjësisë për të ndihmuar dhe për të ecur përpara, pra në bazë të këtyre rezultateve. Perspektiva jonë është shumë e mirë dhe duhet të falënderojmë të gjithë ata që po kontribuojnë në këtë aspekt.

UBT News: A keni shtuar dhe a ka nevojë UBT-ja për përforsim me staf të ri?

Hajrizi: Ne çdoherë po kemi rritje të numrit të studentëve, rritje të programit të studimeve rritje të infrastrukturës dhe kryesorja është rritja cilësore e stafit akademik. UBT-ja ka punuar shumë për t'i ngritur kuadrot tona, duke i dërguar në universitetet partnere për të doktoruar, për të marrë përvoja ndërkombëtare dhe në këtë mënyrë të ecim përpara. Neve çdoherë na duhen kuadro me përvoja të reja, sepse është një sfidë permanente intelektuale që studentit dhe shoqërisë t'i ofrohen të arriturat e fundit. Ne po ashtu kemi një element të veçantë, ndërkombëtarizimin. Kryesisht, 20-30 për qind e programit të UBT-së, mbështetet me staf ndërkombëtar, në mënyrë që të ruhet ndërkombëtariteti. Ne kemi edhe programe që mbahen tërësisht në gjuhën angleze dhe ky është një element i fortë i UBT-së, për të ndërlidhur dhe bartur dijen dhe teknologjinë e fundit deri tek studentët në Kosovë.

UBT News: A do të zgjeroheni me programe të reja, përfshirë këtu edhe me ngritjen e nivelit të studimeve, deri në doktorata, pasi që Kolegji UBT, tashmë ka një përvojë akademike 15-vjeçare.

Hajrizi: Ne kemi aplikuar për akreditim për studime të doktoratës dhe presim që të formohet komisioni për vlerësim. Jemi pjekur pas një kohe të gjatë të veprimtarisë dhe në bazë të zhvillimit të kuadrove, kjo duhet patjetër të ndodhë. Studimet e doktoratës janë vende ku gjenerohet dije e re dhe është një funksion i domosdoshëm për institucionet e arsimit të lartë. Në anën tjetër, jemi duke u munduar të jemi fleksibilë dhe proaktivë për krijimin e programeve të reja, për të cilat ka nevojë tregu i punës në Kosovë. UBT-ja gjithmonë ka pasur një lidhje të ngushtë me tregun e punës, prandaj, ne kemi vënë theks të veçantë tek nevoja për studime në fusha të reja, si: shëndetësia, bujqësia, ushqimi etj. Pra, fusha që për neve kanë prioritet për faktin se Kosova dhe bota kanë nevojë për kuadro të reja. Ndërsa, për sa i përket shkencave teknologjike, ne jemi fokusuar mjaftë shumë, por do të fokusohemi akoma më tepër. Mendoj se në UBT ka elemente edhe për zhvillimin e shkencave humane, prandaj do të ketë programe të reja në këtë fushë, të cilat ne do t'i ofrojmë në kuadër të universitetit tonë.

UBT News: Sivjet UBT-ja shënon 15 vjetorin e themelimit, çka nënkupton kjo në një shtet si Kosova, që ende vazhdon të përballlet me problemet e tranzicionit?

Hajrizi: 15 vjet të UBT-së janë një rrefim i suksesit dhe zhvillimit permanent të një institucioni i cili ka filluar prej zeros. Ne kemi filluar në vitin 2001, kurse në vitin 2015 kemi shënuar një përparim të madh. Rezultati më së miri shihet tek fakti që 400 njerëz e përbëjnë stafin akademik, aktualisht UBT-ja ka mbi 9000 studentë dhe është i pranuar për ekselencë, pra është model i ekselencës në aspektin e cilësisë dhe njihet nga qindra universitetet e partnerë ndërkombëtarë.

Ne po ashtu kemi pasur ndikim në zhvillimin ekonomik e shoqëror , e kemi luajtur rol pozitiv si ambasadorë të Kosovës, kemi gjeneruar zhvillime dhe rezultate dhe e kemi thyer paragjykimin që në vendet në tranzicion, siç është Kosova, zhvillime të tilla nuk mund të bëhen. Studentët tanë e kanë zënë vendin e parë në robotikë, kemi hapur programe të reja që për herë të parë janë shfaqur në regjion, kemi zhvilluar gara të ndryshme, kemi hapur shkollën e parë të informatikës në tërë Ballkanin, pastaj edhe shkollën e arkitekturës, shkollën e biznesit, e kështu me radhë.

UBT-ja është pikë reference pozitive dhe është shembull i liderit në aspektin e arsimit të lartë në regjionin e Ballkanit Perëndimor, e tërë këto arritje janë bërë në saje të angazhimit dhe punës së stafit, por edhe studentëve të mirë , të sjellshëm , të interesuar për studime, e me vlera dhe kjo na ka ndihmuar shumë që të arrijmë këtu ku jemi sot. ■

Nga konferenca “Dita austriake-kosovare e integritimeve evropiane”

Busek porositi nga UBT: Kosovarët të japin shembuj për integrim në BE

“Duhet të keni bashkim, ashtu siç ishit të bashkuar për pavarësinë e Kosovës. Nuk duhet të mjaftoheni me historinë, me dhunën e Milosheviqit, por me zhvillimin. Ju duhet të promovoni vendin tuaj me turizëm, trashëgimi kulturore, të vetëmonitoroheni, të bëni më shumë punë, të bëni universitete cilësore për t'i përgatitur gjenerata me edukim, me hulumtime për integritime evropiane etj.”, theksoi Erhard Busek

Erhard Busek, ish-zëvendëskancelar i Austrisë, diplomat i mirënjohur evropian, i angazhuar shumë rreth çështjes së Kosovës, njëherësh koordinator i Iniciativës për Bashkëpunim Juglindor (SECI), në konferencën njëditore: **“Dita austriake-kosovare e integritimeve evropiane”**, organizuar nga UBT-ja dhe Shoqata austriake-kosovare, ka porositur kosovarët që të japin shembuj më praktikë, që të jenë pjesë e integruar brenda BE-së.

Ai, duke u bazuar në gjendjen aktuale në Kosovë, theksoi se edhe Austria pas Luftës së Dytë Botërore, kur po krijohej nga një monarki, kishte probleme dhe ishte afër luftës civile. “Atëherë kishte përplasje të konsiderueshme njëri me tjetrin, por ishte arritur që të mos ndodhte luftë civile, që do të ishte fundi i Austrisë”, saktësoi ai, teksa jepte mesazhin se edhe kosovarët duhet të merren vesh.

Nëse nuk do të merreshim vesh nuk do të shkonim përpara. Kishte diferenca të thella, por kishte qasje për kompromise”, shtoi ai dhe porositi që, pavarësisht diferencave dhe mospajtimeve të brendshme, duhet bashkëpunuar për të mirën e Kosovës. “Duhet të keni bashkim, ashtu siç ishit të bashkuar për pavarësinë e Kosovës. Nuk duhet të mjaftoheni me historinë, me dhunën e Milosheviqit, por me zhvillimin. Ju duhet të promovoni vendin tuaj me turizëm, trashëgimi kulturore, të vetëmonitoroheni, të bëni më shumë punë, të bëni universitete cilësore për t'i përgatitur gjenerata me edukim, me hulumtime për integritime evropiane etj.”, theksoi ai.

Në këtë rrafsh ai e ka lavdëruar UBT-në, si një institucion akademik, që sipas tij, nëpërmjet formave të edukimit po bënë përpjekje të mëdha integrimi. Ndryshe, ka thënë ai, nuk jetohet me historinë, aq më tepër tashti kur Evropa është në fazë kritike, deri në shkapërderdhje.

“Dikush po thotë se po rritet nacionalizmi, por unë po them se nuk ka nacionalizëm, por ka egoizëm”, vuri në pah ai dhe shtoi se Evropa ka probleme refugjatësh dhe se secili mundohet të mbrojë vetveten.

Busek tha gjithashtu se Austria e Kosova janë që të dyja të vogla dhe se varen nga globalizimi. “Pyetja është se, jo vetëm çka duhet t'i sjellë Evropa Kosovës, por edhe çfarë mund t'ia ofrojë Kosova Evropës”, vijoi ai. Në këtë drejtim, ai tha se kosovarët duhet të jenë të vetëdijshëm se pakkush e njeh Kosovën në Evropë, se pesë shtete ende s'e kanë njohur atë. Në tërësi, Busek tha për Evropën se nuk ka diamante, ar e argjend, por e ka trurin. Duke folur për trurin tha se UBT është në rrugë të mirë. “UBT është e ardhme e kontinentit tonë”, vijoi ai, teksa pas UBT-së ka shkuar në takim me presidenten e vendit, Atifete Jahjagën.

Vetë rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ndërkaq, ka folur për hapat pozitivë që Kosova i ka arritur në fushën e arsimim-edukimit gjatë 15 vjetëve të fundit, aq sa është jetëgjatësia edhe e UBT-së. Ai theksoi se Kosova po shkon drejt normalitetit në këtë fushë, se i ka 120 mijë studentë të regjistruar në 450 programe. “Kjo është mesatare e mirë”, shtoi ai, ndërsa u shpreh se UBT-ja në fokus ka internacionalizimin e Kosovës dhe integrimin e saj në Bashkimin Evropian. Tregoi se është i vetëdijshëm se duhet shtuar cilësinë. “UBT është shumë aktiv në edukim, porse është i interesuar që Kosovën ta shohë anëtare të plotë të Sistemit të Bolonjës. Po provojmë që sektorin e edukimit ta bëjmë pjesë të organizatave në rrjete të ndryshme, shkencë e politikë, ndaj besoj që Kosova ka gjëra interesante dhe do t'i nxjerrim në sipërfaqe, si në fushën e edukimit evropiane, ashtu edhe në fushën e industrisë”, u shpreh ai.

Fjalë të mira për miqësinë e Austrisë me Kosovën, në veçanti me Erhard Buskekun, ka folur zëvendësministri në Ministrinë e Integritimeve, Ramadan Ilazi. “Austria historikisht e ka përkrahur Kosovën”, nënvizoi ai dhe konstatoi se Kosova është projekt paqësor, i cili do përforcojë tutje. Ilazi ka folur edhe për liberalizimin e vizave, që sipas tij, nuk është e mirë vetëm për Kosovën si përfituese reale, por edhe për Evropën. Sipas tij, Kosova i ka përmbushur kriteret, por po pret që në prill të vërtetohet një gjë e tillë nga komisionet përkatëse. Ilazi ftoi opozitën që të jetë pjesë e procesit.

Deputeti i Parlamentit të Kosovës, nga radhët e opozitës, Ilir Deda, tha se integrimi evropian është fjalë e ëmbël, porse sipas tij arrihet vetëm me angazhim.

Në kuadër të miqësisë Kosovë-Austri, Karoline Jaoger – Klein, ligjëruese në Vjenë, ka shpjeguar për UNESCO-n, për dështimin e anëtarësimit të Kosovës vitin e kaluar, për anëtarësimin e Austrisë në këtë organizatë, menjëherë pas themelimit etj.

“Kosova ka provuar të hyjë në UNESCO në vitin 2015, por ju duhet të keni politikë kombëtare për ta listuar trashëgiminë kulturore. Lista është instrumenti më i mirë, kurse Kosova duhet familjarizuar me të”, tha ajo.



Agon Mati

Nga UBT në City University

Summer Academy janë atraktive për studentët e UBT-së ngase ata kanë mundësi që talentin dhe të arriturat e tyre gjatë një semestri ti shpalosin përmes punimeve të ndryshme dhe prezantimeve.

Agon Mati, ish-student në UBT në drejtimin e shkencave kompjuterike tregon se Summer Academy dhe kurset që janë ofruar gjatë asaj periudhe përputhen me kërkesat e tregut kosovar në lidhje me teknologjinë dhe programimin. Studentët e UBT-së arrijnë rezultate të mira gjatë studimeve 3 vjeçare, paralelisht mund edhe të punojnë. Por si e arrijnë këtë?

”Duke u angazhuar jashtëzakonisht shumë gjatë ligjëratave, nganjëherë duke shkuar në disa grupe tjera të së njëjtës lëndë, aty ku e kam parë të nevojshme të shkoj përsëri por edhe jashtë fakultetit interesimi im ka qenë i madh”, shprehet Agon Mati, i cili potencon faktin se tani punon në Zetta Technology, kompani kjo në të cilën ai u punësua në korrik të vitit 2015 ende pa i mbaruar studimet.

“Fillimisht jam inkuadruar në kompaninë Frakton si praktikant, por pas një muaji kemi bërë transfer në kompaninë Zetta Technologies, e cila do të merrej me zhvillimin e ueb dhe mobile applications për kompani të huaja dhe gjithashtu zhvillimin e startup-eve të vet kompanisë”, thekson Mati, i cili momentalisht është duke punuar në një startup për Time Management.

Në nivelin e studimeve Master ai është pranuar në dy universitete në City University dhe Utrech University dhe ka përzgjedhur City University për të vazhduar studimet më tutje, ngase sipas tij, ligjëruesit në atë universitet i përkasin industrisë së zhvillimit të lojërave me ekspertë nga kompani të mirënjohura si Sony Entertainment Europe , Rocstar Games, Unity etj. ■



Agon Pacolli

Ndërlidhja e studimeve me punën solli rezultatin e duhur

Agon Pacolli ka studiuar në UBT, në drejtimin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi. Thotë se vendimi i tij për të qenë student i UBT-së është ndikuar së pari nga rekomandimet e shumta nga njerëz të ndryshëm (familjarë, shoqëri, ish-studentë, madje edhe nga njerëzit e botës së biznesit).

“Por, më së shumti jam bindur pas takimin e zhvilluar në zyrat e UBT-së ku më është paraqitur plani studimor, i cili më ka lënë një përshtypje shumë të mirë”, thotë ai.

Ai thotë se lëndët në përgjithësi kanë qenë shumë interesante, por veçon lëndët Menaxhim i strategjisë dhe Ndërmarrësi, Marketing dhe Menaxhim i Operacioneve.

E kur flet një nga ngjarjet e rëndësishme ai veçon njoftimin me profesorin austriak Schari Zafarpour, më të cilin, përmes lëndës "Projekti" u është dhënë mundësia të konfrontohemi me një realitet "evropian".

E nga studimet, Agoni thotë se ka përfituar shumë. “Për shkak se unë kam qenë i punësuar gjatë studimeve, çdo nocion të përfituar në ligjërata kam mundur ta aplikoj menjëherë në punë. Kjo më ka hapur mua shumë rrugë, pasi në ligjërata kemi mësuar të krijojmë alternativa dhe të analizojmë situata të ndryshme”, thotë Agoni.

“Rezultatet janë arritur për shkak të kujdesit të fakultetit ndaj neve studentëve. Mjafton të analizohen përmbajtjet e materialeve të ofruara në Moodle dhe çdo gjë kuptohet. Pas kësaj qëndron edhe disponueshmëria e profesorëve për të sqaruar gjërat, duke ofruar ligjërata shtesë, trajnime dhe përgjigje të shpejtë ndaj pyetjeve përmes e-mailat. Me gjithë këto mundësi mjafton vetëm një dozë e përkushtimit në shtëpi. Po ashtu edhe mundësia e kombinimit të fakultetit me punë ka lehtësuar shumë punën time gjatë studimeve”, thekson z.Pacolli.

Z.Pacolli nga viti 2014 ka filluar punën në kompaninë e sigurimeve “Siguria”. Fillimisht ka qenë "specialist në marrjen në sigurim", pastaj asistent në departamentin e dëmeve dhe, falë sukseset të dëshmuar (mundësuar nga studimet në UBT, duke praktikuar mësimet në punë), ka arrit të ngrihet në pozitën e zëvendës drejtorit të departamentit të dëmeve dhe pastaj nga marsi 2016 është emëruar zëvendës drejtor i Marketingut dhe Marrjes në Sigurim.

Thotë se përveç lëndëve, vet drejtimi i fakultetit "Banka e Financa" ia ka lehtësuar punën pasi kompanitë e sigurimeve janë pjesë e tregut financiar.

Agoni aktualisht është duke vijuar semestrin e dytë të programit Master, ofruar nga UBT dhe është duke shqyrtuar mundësinë për të vazhduar programe të tjera studimi jashtë vendit. ■

Albesa Olluri

Diploma e UBT-së njihet ndërkombëtarisht

Albesa Olluri, studente e drejtimit të arkitekturës në UBT, në një intervistë për revistën Alumni thotë se kushtet e mira që i ka UBT-ja ka qenë një ndër arsytet se pse ajo e ka zgjedhur këtë kolegji.

“Unë vendosa të studioj në UBT për shkak të kushteve të mira që UBT i ofron studentëve të saj, mundësia për trajnime të ndryshme dhe mbi të gjitha diploma e këtij institucioni arsimor njihet ndërkombëtarisht”, theksoi ajo.

Albesa më tutje rrëfen për eksperiencën e saj gjatë 3 viteve. Për të ngjarje e veçantë është vizita në Europë.

Ajo ka treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve dhe këtë e ka arritur me ndihmën e stafit të UBT-së të cilët sipas saj kanë qenë të gatshëm t’i ndihmojnë dhe veçon profesorët që kanë bashkëpunuar me projekte të ndryshme.

Albesa momentalisht është duke kryer praktikën në Ministrinë e Drejtësisë, tek Divizioni i Inxhinieringut, ku merret me projektimin e projekteve të ndryshme, kryesisht burgjeve të Kosovë.

E pyetur për master ajo tha se në një të ardhme të afërt do e vazhdon përsëri në UBT.

“Sigurisht në një të ardhme të afërt planifikoj të vazhdoj studimet master në UBT, duke qenë se i ofron kushtet më të mira për studim në Kosovë”, përfundoi Albesa Olluri. ■



Anesa Hoxha

Gjatë studimeve kam arritur t’i kuptoj të gjitha konceptet ekonomike



Për Anesa Hoxhën UBT-ja dhe profesorët janë të kualifikuar. Për atë arsye ajo zgjodhi UBT-në por edhe nga komentet e gjeneratave paraprake që dolën nga UBT. Lëndët që ajo veçon kanë qenë: Menaxhment Strategjik dhe Ndërmarrësi, Kontabiliteti Financiar dhe Menaxhimi i Projekteve.

Ajo mes tjerash tregon edhe përvojën e saj gjatë 3 viteve. “Gjatë studimeve 3-vjeçare në menaxhment kam arritur që t’i kuptoj të gjitha konceptet ekonomike me anë të ligjëratave dhe ushtrimeve. Pothuajse çdo njohuri që e përfituam tash po e zbatojmë në praktikë”, citoi Anesa e cila tani është duke kryer praktikën në Gjykatën e Apelit.

Anesa përpos fakultetit ekonomik në UBT ka vazhduar edhe në drejtimin e Juridikut në Universitetin e Prishtinës. “Unë tani jam e fokusuar ta përfundoj fakultetin juridik ku aty jam në vitin e fundit dhe pastaj do vazhdoj me master”, përfundoi Anesa Hoxha. ■

Arber Rrustemi

Ish-studenti i UBT-së digjitalizon pajisjet e vjetra industriale

Ish-studenti i Mekatronikës, Arber Rrustemi, nga shkathësitë e fituara në UBT, ku i ka përfunduar studimet e nivelit master, ka arritur të digjitalizojë pajisjet e vjetra industriale. Ai ka hapur një biznes privat, përmes së cilit ua lehtëson punën fabrikave dhe fuqisë punëtore në Kosovë. “Përfundimi i studimeve në UBT më ka ndihmuar në përfitimin e njohurive të reja, të cilat tash i shfrytëzoj në punën që po e bëj”, theksoi Rrustemi, teksa tregoi se rezultatet e arritura gjatë studimeve kanë ardhur duke iu falënderuar ligjërimit të thjeshtë dhe të qartë të profesorëve, por edhe angazhimit të tij maksimal.

Ai tha se është shumë i kënaqur me mënyrën e ligjërimit dhe gatishmërinë që kanë shfaqur profesorët për t’i dalë në ndihmë kurdo që ai ka pasur nevojë, si dhe me kushtet që i ofron ky institucion.

“UBT-ja është padyshim ndër institucionet më të mira dhe më kualitative të arsimit të lartë në vend, duke filluar nga profesorët e deri tek objekti e sallat, të cilat i plotësojnë të gjitha kriteret për ligjërime cilësor”, tha Rrustemi. ■



Alma Feka

Studentja e Gjithanshme e Sistemeve të Informacionit

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT?

- Ta them të drejtën, fillimisht nuk e dija se çfarë do të studioja. Kosova ka një numër drejtimesh të kufizuara dhe asnjëri prej tyre nuk më duket mjaftueshëm atraktiv për të shpenzuar vite të tëra në të, e as talenti si vizatimi apo shkrimi kreativ nuk është i vlerësuar mjaftueshëm për të fituar kafshatën e gojës. Vëllezërit e mi, të dy kishin përfunduar studimet në UBT, njëri në Shkenca Kompjuterike dhe tjetri në MBE. Unë admiroja suksesin e tyre. Kështu edhe pse nuk kisha ndonjë pasion për Shkenca Kompjuterike e as MBE, vendosa të zgjedh drejtimin hibrid të tyre, Sistemet e Informacionit, i cili në atë kohë ekzistonte vetëm në UBT, me shpresë se ndoshta gjatë studimeve do të kuptoja se ç'profesion do të doja në të ardhmen.

UBT Alumni: Cilat kanë qenë lëndët e juaja të preferuara?

- 90 për qind të lëndëve që studiova ishin territor i ri për mua, kështu pëlqimi i lëndës ishte shpesh i varur nga profesorët që e ligjëronin atë dhe qasja të cilën kishin ndaj studentëve, po ashtu edhe niveli i kreativitetit që isha e lejuar të shprehja. Lëndët e mia të preferuara ishin: Marketing, Menaxhment Strategjik dhe Ndërmarrësi, Sjellja në Organizatë dhe Lidërsip, Metodat e Hulumtimit dhe Të folurit publik në Gjuhën Angleze.

UBT Alumni: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?

- A thua si kuptohen fjalët "ngjarje të rëndësishme" për të tjerët. Për mua, ngjarjet e rëndësishme kanë të bëjnë me njerëzit rreth meje të cilët i shkaktojnë ato, kështu edhe gjërat më të thjeshta kanë vlerë si: një fjalë miradie nga profesorët, një ditë kur kam bërë një mik/mikeshë, një drekë e ngrënë së bashku me shoqërinë derisa prisnim për të filluar ligjëratat, një semestër i ri me profesorë të rinj, një shaka në mes të ligjëratës, një lajm që kam kaluar provimin, një prezantim i përfunduar me sukses, një ditë kur më ka bërë dikush një të mirë, një telefonatë për t'u treguar prindërve që kam kaluar provimet, një "Bravo t'koftë" nga prindërit e mi. Varet nga perspektiva e njeriut.

UBT Alumni: Sa keni përfitur nga programet e studimit në UBT?

- Nëse krahasoj veten kur kam filluar studimet me njeriun që jam tani, do të thosha që kam përfitur mesatarisht. Kam njohuri të përgjithshme rreth Shkencave Kompjuterike dhe MBE-së mirëpo nuk jam e specializuar në asnjërën prej tyre. Ka mjaftueshëm hapësirë për t'u përmirësuar programet dhe për t'u ligjëruar disa lëndë të rënda teorike në mënyra më kreative për studentët.

UBT Alumni: A keni përfitur nga mundësitë që ofron UBT për udhëtime studimore, studime jashtë vendit përmes UBT-së, internship apo forma të tjera të angazhimit?

- Definitivisht. Gjatë vitit të fundit studimor isha e angazhuar në UBT si tutore në lëndët Matematikë, Menaxhment Strategjik dhe Ndërmarrësi. Ishte interesant se gjatë periudhës së njëjtë kohore punoja si tutore, por isha edhe studente, kështu që kisha mundësinë të vështroja situatën nga pikëpamja e një profesori dhe e një studenti të thjeshtë. Kam mësuar që sado mirë të sillesh dhe e përgatitur të jesh, do të ketë gjithmonë dikë që nuk pëlqen mënyrën tënde të punës. Nganjëherë do të kesh studentë dhe profesorë që të falënderojnë për punën dhe mundin e bërë dhe nganjëherë ndokush nuk do të dhuroj shumë respekt, sepse si rol je lehtë i zëvendësueshëm. Falënderoj UBT-në për këtë mundësi, sepse kam fituar shumë përvojë, edhe nëse nuk ishte gjithmonë pozitive.

UBT Alumni: Ju keni treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?

- Faleminderit për komplimentin. Seriozisht, nuk ka ndonjë formulë speciale për të arritur rezultate të mira. Isha rregullisht prezente në ligjëratat, isha aktive gjatë debateve, i kam punuar projektet individuale dhe grupore me qejf. Të jem e drejtë me ju, ka pasur raste ku projektet më kanë shpëtuar rezultatin e përgjithshëm të lëndës, sepse jo çdoherë isha e përgatitur mirë në provime. Për mua provimet shpeshherë dukeshin si teste memorie, sepse ishin të strukturuar për të kërkuar definicione, klasifikime etj. Këto gjëra unë i harroj lehtë edhe pse mësimin ndoshta e kuptoj thelbësisht. Jam e kënaqur që ka alternativa për të treguar studenti inteligjencën dhe aftësitë oratorike në mënyra tjera, sidomos projekte seminarike dhe eseistike. Një këshillë që e zbatoj vetë gjatë punimit të këtyre projekteve është se gjej një temë për të cilën jam e interesuar të hulumtoj dhe disi e lidhi me lëndën. Për shembull, edhe nëse muzika si muzikë nuk ka të bëjë me ekonominë, mund të shndërrohet në temë interesante dhe relevante, duke implementuar muzikën si thelb dhe ekonominë si mbështjellës. "Si ndikon industria e muzikës Kpop në të ardhurat e Koresë Jugore?" është temë që përfshin të dyja dhe për interes si nga ana ime ashtu edhe nga ana e profesorit.

UBT Alumni: A jeni duke punuar pas studimeve dhe ku?

- Momentalisht punoj si freelancer. Së bashku me vëllezërit e mi jemi duke krijuar një gaming company, të fokusuar rreth lojërave kompjuterike 2D. Emri i kompanisë sonë është Galanx dhe tashmë do të bëhen tri vite të investuara në krijimin e projektit tonë të parë, që quhet Konstandin. Konstandin, është lojë 2D e zhanrit horror/puzzle/adventure dhe është e bazuar lehtë në legjendën shqiptare "Besa e Konstandinit". Unë kam për detyrë dizajnimin e personazheve, vendndodhjeve, krijimin e rrëfimit, dialogëve dhe të puzzles.

Tani kemi përfunduar më tepër se 70% të lojës dhe jemi duke përgatitur një kampanjë për Kickstarter (që është një ndër websites më të mëdha për crowdfunding) dhe Steam (platformë për shitjen e lojërave).

Punë tjetër që bëj është krijimi i storyboards për video muzikore, i skriptave, poezive, përrallave dhe novelave në gjuhën angleze me porosi. Po ashtu jam e angazhuar përherë si përkthyes e teksteve në gjuhën shqipe, angleze dhe gjermane të natyrës politike, zbavitëse, mjekësore etj.

Një punë të cilën e bëj më rrallë, mirëpo që kam gjithashtu përfitim prej saj është krijimi i vizatimeve tradicionale me porosi, dhe mund të varioj prej një sketch-i të thjeshtë deri tek punime më të detajuara.

Pasi punët me të cilat merrem janë të natyrës artistike, ato vlerësohen dhe porositen më tepër nga të huajt sesa shqiptarët.

UBT Alumni: A jeni duke vazhduar studimet?

- Tani për tani, jo. Kam pasur oferta për të vazhduar studimet në Gjermani, Londër dhe Irlandë, por kam pauzuar një vit ngaqë dëshiroja t'i kushtoja më tepër vëmendje zhvillimit të Konstandin-it. Pasi tashmë një pjesë e madhe e punës sime në të është kryer, planifikoj të vazhdoj studimet master këtë vit, me fokus në drejtimin e Menaxhmentit dhe Ndërmarrësisë. ■



Ardonita Beqiri

Kur sheh programet e UBT-së, e heq dilemën ku do të studiosh

Ardonita Beqiri, pas përfundimit të gjimnazit shkencor, e kishte të vështirë të vendoste drejtim që do të studionte, po ashtu edhe universitetin. Por, në ndihmë i dolën broshurat informuese të UBT-së, që rastësisht i ranë në dorë.

“I kam shikuar programet dhe lëndët dhe më zgjoi një interesim të shkoj ta vizitoj UBT-në. Pas informatave që mora gjatë vizitës vendosa që studimet e mia t’i nisë në UBT”, thotë Ardonita Beqiri, që studio Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, e ku lëndët që i bënë më së shumti përshtypje ishin Metodatat statistikore 1 dhe 2, Kontabiliteti menaxherial, Menaxhimi financiar, Institucionet financiare dhe Makro dhe mikro ekonomia.

E ngjarja më e rëndësishme për të ka qenë ceremonia e diplomimit, një ceremoni me plot emocion e krenari, e një finalizim shumë i mirë i studimeve.

Përveç që ka përfituar shumë nga programet e studimit, ajo ka përfituar mundësinë për një internship në Telekom e Vala në Ferizaj, në kohëzgjatje prej 3 muajsh.

Suksesi thotë se e ka arritur me shumë përkushtim, me ndjekje të ligjëratave dhe ushtrimeve, si dhe duke i përcjellë ligjëratat shtesë që i ofron UBT.

Në fund, ajo thekson se, si studimet themelore, edhe studimet master, me shumë kënaqësi, i vazhdon në UBT. ■

Arian Sefiu


Nga UBT në “Dessau Institute of Architecture” në Gjermani

Falë njohjes ndërkombëtare të diplomave të kolegjit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Arian Sefiu, ish-student i UBT-së, i cili ka përfunduar studimet Bachelor në degën e Arkitekturës, është pranuar pa ndonjë provim pranues për studime të nivelit master në “Dessau Institute of Architecture” në Gjermani.

Këtë e ka bërë të ditur vetë Sefiu sipas të cilit në bazë të aftësive të arritura dhe njohurive të marra nga programet e studimit në UBT, ka arritur të vazhdojë studimet jashtë vendit.

“E mira e UBT-së është se sigurisht është pranuar edhe ndërkombëtarisht andaj kam pasur mundësinë të vazhdoj me master pa ndonjë provim shtesë apo diçka të tillë”, ka thënë Sefiu, duke shtuar se është përvojë e mirë të qëndrojnë në qytetin e Bauhaus, qytet ky i njohur për ndërtesa arkitekturale.

Sefiu i cili aktualisht është duke studiuar për arkitekturë të përgjithshme në Gjermani, shprehet të ndihet i kënaqur me aftësitë e fituara nga studimet në UBT. Lëndët me të preferuara të tij kanë qenë Studiot, lënda Kreativitet, Gjeometri Deskriptive, Teori e Arkitekturës dhe Histori e Arkitekturës. ■



Bajram Biqkaj

Në UBT është një staf me performancë të lartë profesionale e akademike



Ish-studenti i UBT-së, Bajram Biqkaj, i cili gjatë vitit akademik 2011-2014 ka studiuar dhe i ka përfunduar studimet në drejtimin e Arkitekturës në këtë institucion të arsimit të lartë, tashmë është menaxher i një kompanie private.

Ai thekson se përfundimi i studimeve themelore – baçelor në UBT e ka bërë atë të performojë aftësi profesionale dhe të përparojë në punë.

“Pasi përfundova studimet e nivelit baçelor, aftësitë profesionale të fituara nga UBT-ja më mundësuan t’i qasem punëve në njërin nga kompanitë më serioze të projektimit dhe ndërtimit në Kosovë ‘Bashkimi Projekt’”, ka thënë Biqkaj, duke treguar se në fillim ishte vetëm praktikant në menaxhimin dhe organizimin e kantierit të ndërtimit.

“Mirëpo, pas një periudhe të shkurtër, kompania e fitoi besimin dhe më dha detyrën e menaxhimit të organizimit të një pune ndërtimore në kompleksin ‘Derin-Residence’, në Lagjen e Muhaxhirëve në Prishtinë, që ishte një investim rreth 6 milionë euro”, ka vijuar ai. Sipas tij bëhet fjalë për një kompleks afarist – banesor, me 4 njësi banimi.

Biqkaj tregon se në atë kompani ka bërë një përvojë dyvjeçare. Si sukses tjetër që ai e vlerëson është se kanë arritur ta themelojnë një kompani të re projektimi, qëllimi i së cilës është sjellja e një fryme të re në Arkitekturë, që po ashtu është aftësi e fituar nga studimet në UBT.

Në përfundim të rrëfimit të tij për përparësitë që ia ka krijuar shkollimi në UBT, saktësisht në drejtimin e Arkitekturës, Biqkaj shprehet të ndihet ende i kënaqur.

“Në UBT është një staf me performancë të lartë profesionale e akademike”, ka përfunduar ai. ■

Besim Shala

I diplomuari i UBT-së, asistent i matematikës dhe pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme



Ish-studenti i UBT-së në degën e Shkencave kompjuterike, Besim Shala ka arritur që menjëherë pas përfundimit të studimeve të bëhet asistent i profesorit të UBT-së Azir Jusufi, i cili e ligjëron lëndën e matematikës, si dhe është pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku punon në profesionin për të cilin edhe ka studiuar.

Ai tha se sukseset e arritura kanë ardhur falë angazhimit dhe punës së tij, si dhe profesorëve të UBT-së, të cilët sipas tij janë më të mirët në vend.

“Gjatë studimeve në UBT kam arritur që të aftësohem tejte shumë për profesion dhe punën të cilën aktualisht edhe po e ushtroj”, theksoi Shala, teksa shtoi se ka vendosur të studiojë në UBT për shkak të fjalëve të mira të cilët i kishte dëgjuar nga të tjerët që ishin pjesë e UBT-së para tij.

“Ky institucion i arsimit të lartë është ndër më të mirët në vend dhe është fati im që në një mënyrë jam ende pjesë e tij”, tha Shala. ■

Blin Bakija

Projektet e ish-studentit të UBT-së përdoren në tërë tregun e Kosovës

I diplomuari i UBT-së në Shkenca Kompjuterike, Blin Bakija pas përfundimit të studimeve në nivelin baçelor, e ka gjetur veten menjëherë në tregun e punës. Ai është duke punuar në kompaninë private “Bbros”, si zhvillues i web-it dhe projektet e tij përdoren në tregun e Kosovës. Bakija tha se rezultatet e arritura kanë ardhur falë angazhimit të madh të profesorëve dhe interesimit të tij si student. “Punën e parë si programer e kam bërë gjatë kohës sa kam qenë pjesë e praktikës që e ofron UBT-ja”, tha ai, teksa shtoi se përvojat dhe mësimet e marra nga profesorët e UBT-së, ai sot i zhvillon në punën që e bën.

“Regjistrimi në UBT ka qenë ndër vendimet më të mira të jetës sime, sepse pa qenë pjesë e UBT-së unë nuk do të isha ky që jam sot”, u shpreh Bakija. ■




Dodona Blakaj

UBT-ja hap udhë për studime pasuniversitare në Evropë

Dodona Blakaj, arkitektja e re, e cila i ka përfunduar studimet themelore në UBT, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, është pranuar për t'i vazhduar studimet pasuniversitare, master, në universitetin "Politecnico di Milano", më i madhi dhe më i vjetri në Itali, me rreth 40 mijë studentë.

Ajo ka treguar se ka fituar edhe bursë të studimeve për drejtimin "Architectural Design and History". Blakaj i ka përfunduar studimet themelore në UBT, në korrik të vitit të kaluar. Përshtypjet e saj për UBT-në vazhdojnë të jenë të shkëlqyeshme.

“UBT-ja ofron mundësi të mëdha për ngritje profesionale, të krahasueshme me nivelin e universiteteve evropiane”, ka thënë ajo dhe ka shtuar se pikërisht për shkak të nivelit të barabartë, studentët e UBT-së kanë mundësi të zgjedhin për studimet e mëtejme. “Studentët i kanë rrugët e hapura për t'i vazhduar studimet në shumicën e universiteteve të mirënjohura evropiane e ndërkombëtare”, ka thënë ajo për UBT-në, duke folur fjalë të mira edhe për menaxhmentin dhe për stafin akademik brenda. “Profesorët e UBT-së janë të një niveli të lartë akademik. Ata sjellin standarde ndërkombëtare për zhvillimin e programeve të studimit dhe janë gjithmonë të gatshëm e transparentë, për të ndihmuar studentët për ngritje profesionale”, është shprehur ajo. Po ashtu, i vlerëson lart edhe kushtet infrastrukturore në UBT. “Në UBT mund të studiohet dhe të punohet, pasi që është institucion i lartë i arsimit në Kosovë, që investon shumë, krejt me qëllim të rritjes së cilësisë dhe inovacionit në mësimdhënie”, ka përfunduar ajo. ■



Doruntina Mejzini

Studimet në UBT, garanci për sukses



Doruntina Mejzini ka përfunduar studimet në Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, ku tash vazhdon studimet në nivelin master. Për “UBT Alumni” rrëfen sfidat dhe sukseset e saj gjatë studimeve në UBT.

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT?

Mejzini: Pas përfundimit të shkollës së mesme erdhi koha të vendosja për të ardhmen time. Dëshira e parë ishte që të vazhdoja studimet në FSHMN – Matematikë Financiare dhe pas dy herëve të aplikimit nuk u pranova, duke marrë parasysh nivelin dhe rrjedhjen e gjërave në Kosovë. Atëherë fillova të hulumtoj për universitet private në Kosovë dhe ai i cili kishte programin më të mirë arsimor dhe një staf akademik të kualifikuar ishte UBT”.

UBT Alumni: Cilat kanë qenë lëndët e juaja të preferuara?

Mejzini: Gjithmonë i kam preferuar shkencat natyrore (matematikë, fizikë, kimi, biologji), lëndët financiare dhe biznesin. Gjatë tri viteve të studimit do t’i veçoja këto lëndë: Kontabiliteti financiar dhe ai menaxherial, Standarde ndërkombëtare të

kontabilitetit, Makroekonomia, Mikroekonomia, Investimet dhe Analiza Financiare, Marketing, etj.

UBT Alumni: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?

Mejzini: Gjatë tri viteve të studimit kishte momente shumë të mira dhe me shumë stres. Koha e kollokfiumeve dhe të provimeve ishte koha kur duhej të testoja veten dhe të vlerësohesha për punën që kisha bërë. Prezantimi i punimeve seminarike dhe projekteve të shumta ishin një urë lidhëse për ndërlihdjen e teorisë me praktikën. Momenti kryesor dhe më i veçanti në këto vite ishte ceremonia e diplomimit. Një emocion, një sukses dhe një arritje për të vazhduar tutje, thjesht një ndjenjë e papërshkrueshme.

UBT Alumni: Sa keni përfituar nga programet e studimit në UBT?

Mejzini: UBT karakterizohet me një program akademik studimor shumë të mirë dhe nëse dëshiron të mësosh dhe të ecësh tutje është vendi më i mirë. Një ndërthurje e lëndëve të fushave të rëndësishme të ekonomisë dhe biznesit me numrin e orëve të ligjëratave janë të mjaftueshme për një sukses dhe përgatitje për tregun e punës.

UBT Alumni: A keni përfituar nga mundësitë që ofron UBT për udhëtime studimore, studime jashtë vendit përmes UBT-së, internship apo forma të tjera të angazhimit?

Mejzini: UBT-ja është një universitet me standard të larta dhe ka një filozofi të përkryer që t’ju ofroj studentëve mundësitë më të mira për punë dhe intership. Në vitin e dytë kam përfunduar 2 muaj praktikë në zyrën e projekteve së UBT-së dhe në vazhdimi kam pasur mundësinë për praktika të tjera. Gjithashtu, pasi kam vazhduar studimet master në UBT kam marrë ofertë për aplikim për vazhdimin e studimeve jashtë vendit.

UBT Alumni: Ju keni treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?

Mejzini: Rezultatet e mira gjatë studimit i kam arritur me punë, përkushtim dhe mund. Përkushtimi për marrjen e informative të reja dhe shkuarja në ligjëratat janë njëra ndër pikat kryesore për rezultatin e arritur. Kurioziteti dhe dëshira për arritje në karrierë janë motivim për punën e vazhdueshme.

UBT Alumni: A jeni duke punuar pas studimeve dhe ku?

Mejzini: Tani për tani jam në një biznes privat në pozitën e financave (duke marrë përvojën e duhur për certifikim në nivelin e parë në SCAAK) dhe në përfundimin e angazhimeve të filluara. Nuk kam vendosur ende të filloj një punë konkrete sepse mëdyshja midis punësimit diku dhe fillimit të biznesit privat është e madhe. Besoj dhe shpresoj që në të ardhmen të kem biznesin tim. ■

Egzon Jusufi

Ish- studenti i UBT-së shfaq aftësitë profesionale në Zvicër

I diplomuari i UBT-së në drejtimin e arkitekturës në nivelon bachelor, Egzon Jusufi është duke kryer praktikë njëvjeçare në një byro të arkitekturës në Zvicër, e cila është obligative për të ndjekur studimet e nivelit master. Ai tha se studimet për arkitekturë në nivelin master do t’i vazhdoj në njërin prej universiteteve të njohura në qytetin Lausanne të Zvicrës.

“Vitet e studimeve ishin sa të mira, aq edhe të vështira e sfiduese, por unë kam gjetur mbështetje në vendin e duhur”, tha Jusufi, duke iu referuar profesorëve të UBT-së, të cilët sipas tij, janë më të mirët në Kosovë dhe më gjerë.

Ai tha që përherë do t’u jetë falënderues profesorëve të UBT-së për mundësitë e ofruara dhe njohuritë e fituara nga ta. ■



Dukagjin Hyseni

UBT ofron shumë mundësi

Për Dukagjin Hysenin UBT-ja ka ofruar shumë mundësi të intershipit dhe exchange të studentëve me universitete të ndryshme të botës. I pyetur se si ka arritur të tregojë rezultate të mira gjatë studimeve, ai ka thënë: “Më kanë ligjëruar shumë profesor të mirë e të aftë. Kur e them të mirë e them në kuptimin e ofrimit të mbështetjes morale në punë dhe projekte të ndryshme duke mos kursyer asgjë. Kur e them të aftë e them se çdo herë na ofronin ndihma dhe këshilla profesionale. E nga e gjithë këto angazhime unë domosdoshmërisht e kam arritur rezultatin që edhe vetë nuk e kam pritur. Me këtë rast shfrytëzoj rastin të i falënderoj gjithë profesorët e mi duke mos cek emra se frikohem e i harroj të tjerët”.

Po ashtu, Dukagjini shtoi se kolegji UBT e kishte përgatitur mjaft mirë për tregun e punës e që tash është menaxher i departamentit të IT-së në një institucion privat që merret me botime shkencore.


Dukagjini nuk mendon asnjëherë që t’i lë studimet, ai tashmë kishte aplikuar në dy universitete dhe ishte duke pritur përgjigje nga të dyja. Dhe sa i përket lëndëve të tij të preferuara ato ishin Net dhe Databasse.

Po ashtu ai nuk ngurroi ta ndaj me ne arsyen se pse e ka zgjedhur UBT-në si mundësi shkollimi: “Pas studimeve fillestare të bachelor në Universitetin e Europës Juglindore (SEEU), Tetovë, kisha vullnetin dhe dëshirën më të madh që edhe studimet Master t’i vazhdoj menjëherë pas përfundimit të suksesshëm të studimeve bachelor. Si kam vendosur për UBT është shumë thjesht, ngase çdokënd që e pyesja ose bisedoja për universitetet private në Kosovë të gjithë më rekomandonin UBT, të gjithë kishin fjalë të mira për studimet në UBT”, ka thënë Dukagjin Hyseni për revistën “Alumni”.



Erduan Hoxha

Përkushtimi i UBT-së – avancimi i të rinjve për treg të punës



Pas studimeve të suksesshme në nivelin bachelor në UBT respektivisht në drejtimin e shkencave kompjuterike, ish-studenti Erduan Hoxha, është punësuar në kompaninë “Tribeisya L.L.C” në pozitën inxhinier i Softuerit.

Hoxha suksesin e tij të treguar në këtë fushë ia atribuon stafit të UBT-së të cilët, sipas tij, kanë dhënë maksimumin e tyre për ngritjen profesionale të studentëve.

“Programet e UBT-së më mundësuan të fitoj njohuri të përgjithshme për këtë drejtim.

Aktualisht jam i punësuar në kompaninë vendore në pozitën Full-Stack Web Developer”, tha thënë Hoxha.

“Ndërkohë kam aplikuar në Universitetin e Fribourg-ut ku besoj dhe shpresoj që shumë shpejt të marrë përgjigje pozitive dhe të vazhdoj studimet atje në shtatorë 2016”, ka shtuar ai.

UBT tashmë ka krijuar bashkëpunim rajonal në mes të institucioneve të arsimit të lartë, në pothuajse të gjitha fushat studimore, kjo falë krijimit të kapaciteteve në infrastrukturë të konkurrueshme ndërkombëtarisht. Kjo u hap perspektivë të rinjve kosovarë sepse përkushtimi i UBT-së ka të bëjë me avancimin e të rinjve për treg të punës.

Bardha Meta

Të diplomuarit në UBT me rrugë të hapura studimi e punësimi

Gjithnjë e më shumë po dëshmohet se të diplomuarit në UBT kanë lehtësira për të siguruar një vend pune, apo për t’i vazhduar studimet pasuniversitare në shtete të ndryshme evropiane, e më gjerë.

Nga rastet e shumta, të publikuara e të papublikuara në media dhe rrjete sociale të brendshme, do veçuar të diplomuarën në Degën e Arkitekturës në UBT, Bardha Metën. Meta tregon se pas përfundimit të studimeve themelore, nga muaji shkurt është punësuar në një Zyrë projektuese “Abd&associates”.

Gjithashtu, ajo ka arritur të pranohet për studime të nivelit Master, në Universitetin publik “Politecnico di Milano”, në Itali.

“Ky universitet më ka shpërblyer me bursë për studime, duke e mbuluar edhe pagesën e fakultetit dhe konviktin”, ka thënë Meta, me rrëfimin se një mundësi e tillë, brenda një viti akademik, u jepet vetëm 10 studenteve më të mirë.

Për rrugëtimin e suksesshëm të saj, Meta i është mirënjohëse UBT-së.

“Jam mirënjohëse ndaj UBT-së, që gjithmonë na ka dhënë mundësi të mëdha për zgjerimin e njohurive dhe na ka mbështetur për qëllimet tona si studentë”, thotë Meta.

Në kuadër të Javës së Ndërmarrësisë

Studentët e UBT-së prezantuan 17 biznes-plane

“Është kënaqësi që të kemi mundësi të motivohemi nga studentët tanë. Kjo fushë gjeneron pozitivitet, rritje, kreativitet që shkon në ndikim të zgjerimit të përgjithshëm të dijes në ndërmarrësi dhe inovacion”, u shpreh rektori Hajrizi në ceremoninë e prezantimit të biznes-planeve

Mbi 65 studentët të Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi të UBT-së të angazhuar në përgatitjen e biznes-planeve, në kuadër të lëndës Menaxhimi Strategjik dhe Ndërmarrësi, prezantuan sot 17 biznes-plane, në kuadër të Javës së Ndërmarrësisë.

Biznes-planet e studentëve përfshijnë tema nga më të ndryshmet, si: Kompania për riciklimin e aluminit; Fabrika për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e djathit; Prodhimi/Përpunimi i biskotave; Kultivimi i karotës; Bujtina në Bogë "Panorama"; Prodhimi i ciderit "Logrin Hard Cider"; Internet Service Provider – ISP; Serra për kultivimin e luleve; Sistemi online i parkimit; Prodhim i qarqeve elektronike; Çerdhja për fëmijë; Mbjellja dhe kultivimi i aronisë; Kultivimi i drurit Paulownia; Salt therapy; "Dardha"; Ngritja e fermës e të tjera.

Studentët e angazhuar në punimin e biznes-planeve janë: Vlora Belallari, Elona Miftaraj, Gentiana Qorri, Faton Mirena, Burim Kastrati, Fiona Prokshi, Rina Velu, And Deva, Manuella Berisha, Valerina Colaj, Qëndresa Shabani, Tenzilla Luboteni, Hamide Zabeli, Arjeta Mehmeti, Edona Kullashi, Marigona Nikçi, Gent Sefa, Faton Jashari, Donjeta Gashi, Florenta Fetoshi, Jonida Xhema, Krenar Çeku, Rilind Beqaj, Agon Hysaj, Benita Sylja, Mirjeta Sylja, Fjolla Hisari, Flakadon Osmani, Ejup Lahu, Nuha Hasani, Halil Berisha, Visar Maxhuni, Samir Shala, Roni Kasemi, Jeton Mullarama, Art Berisha, Imri Jezerci, Drilon Shala, Endrit Hoxha, Albin Hasaj, Driton Jashanica, Albana Popova, Arbana Prelvukaj, Egzona Morina, Granit Hajrizi, Premtim Zejnullahu, Afije Gashi, Dhurata Azemi, Xhejlane Imeri, Merita Dabinovci, Vjosa Cena, Fitim Luma, Reis Sallova, Blerim Llugini, Mustafë Salihu, Donat Polloshka, Gent Shkodra, Drilon Selmani, Myekked Konstantini, Lendita Kadriu, Anesa Koprani e Lumir Krasniqi.

Në ceremoninë e prezantimit të biznes-planeve morën pjesë përfaqësues të institucioneve, përfshirë, zonjën Besa Zogaj, zëvendësministre e Zhvillimit Ekonomik në Qeverinë e Republikës së Kosovës, profesore, studentë e mysafirë të tjerë. Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi u shpreh i kënaqur që UBT-ja çdo ditë e më shumë me nisma të ndryshme po krijon mundësi për studentët që të tregojnë dijen dhe punën e tyre hulumtuese.

“Është kënaqësi që të kemi mundësi të motivohemi nga studentët tanë. Kjo fushë gjeneron pozitivitet, rritje, kreativitet që shkon në ndikim të zgjerimit të përgjithshëm të dijes në ndërmarrësi dhe inovacion”, u shpreh dr. Hajrizi.

Ai më tutje vazhdoi se ideja e ndërmarrësisë është që të ngritet kultura, që të ketë qasje sa më të madhe të individit, për të bërë diçka të re, një qasje e cila gjeneron rritje e zhvillim.

Ndërmarrësia është potencial i madh dhe faktori kryesor të ecim përpara, tha Hajrizi.

Ai përmendi krijimin e inkubatorit universitar që ka pasur mbështetje nga ndërkombëtarët si dhe inkubatorit virtual të Kosovës, që është i pari në vend e në rajon, një projekt që është i mbështetur nga SHBA, si dhe shumë nisma të tjera, që kanë ndikuar në ngritjen e nivelit të hulumtimit dhe punës shkencore dhe u kanë dhënë mbështetje studentëve për jetësimin e ideve të tyre.

Besa Zogaj, zëvendësministre në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, tha se për të është shumë privilegj të jetë në këtë vend të rëndësishëm, para studentëve të dalluar që prezantojnë idetë e tyre.

Ajo shtoi se sektori privat është promotori kryesor i zhvillimit ekonomik, është shtyllë e parë e programit qeveritar 2015-2018. Duke përmendur disa nga nismat e ekzekutivitetit të vendit për përkrahjen e ndërmarrësisë, ajo përmendi pakon e re fiskale, që ka ndikuar dhe janë duke u vërejtur përparësitë e të bërit biznes, si dhe fondin për garantime në vlerë 18 mijë euro, i mbështetur nga USAID dhe Komisioni Evropian, që ka për qëllim të promovojë sektorin privat dhe bizneset që udhëhiqen nga femrat dhe në zona rurale.

Dr. Ylber Limani, dekani i Fakultetit të Menaxhment, Biznesit dhe Ekonomisë, tha se Java e ndërmarrësisë, në kuadër të së cilës po bëhen prezantimet, është pasqyrimi i punës dhe dijes që kanë mbledhur studentët gjatë pesë semestrave të studimeve. “Ky është moment që ju do ta krijoni një biznes-plan, që do të jetë një trokitje në derë të bizneseve të reja për të krijuar diçka të re”, tha dr. Limani.

Sipas tij, nuk është e lehtë që studentët të jenë ndërmarrës e për ta arritur këtë duhet të veprojnë më shpejt, të arrijnë në qëllimin që e kanë synuar këta biznesmenë të rinj.



Biznes-planet e studentëve përfshijnë tema nga më të ndryshmet, si: Kompania për riciklimin e aluminit; Fabrika për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e djathit; Prodhimi/Përpunimi i biskotave; Kultivimi i karotës; Bujtina në Bogë "Panorama"; Prodhimi i ciderit "Logrin Hard Cider"; Internet Service Provider – ISP; Serra për kultivimin e luleve; Sistemi online i parkimit; Prodhim i qarqeve elektronike; Çerdhja për fëmijë; Mbjellja dhe kultivimi i aronisë; Kultivimi i drurit Paulownia; Salt therapy; "Dardha"; Ngritja e fermës e të tjera.

Ndërsa, Armend Muja, ligjërues i lëndës Menaxhimi strategjik i ndërmarrësisë, në kuadër të së cilës janë përgatitur biznes-planet, tha se për UBT-në është shumë e rëndësishme qasja strukturore si institucion dhe mbështetja e studentëve për hartimin e të gjitha planeve.

Organizimi në fushën e biznes-planeve dhe prezantimi i tyre ka qenë pikë kyçe për drejtimin e Biznesit në UBT, shtoi Muja. Ai përmendi disa aspekte në krijimin e një biznes-plani të një studenti fillestar, duke theksuar se aspekti i parë është qasja në financa, aspekti i dytë sistemi arsimor – kontribut që në edukimin fillor ai të mësohet të bëjë biznes, aspekti i tretë barriera e biznesit, femrat kosovare të zonjat dhe të suksesshme në biznes, si dhe aspekti i katërt, që është aspekti individual.

Z. Muja tha se në këtë lëndë çdo vit studentët me ide inovative kanë hartuar biznes-plane dhe i kanë prezantuar.

Sipas tij, Kosova ka nevojë që të ketë njohuri të reja rreth kësaj fushe, ndërsa përmendi edhe përkrahjen e Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë, e cila e ka mbështetur UBT-në në realizimin e shumë projekteve të rëndësishme.

Në ceremoninë e sotme morën pjesë edhe studentët që kanë përfunduar studimet në UBT, e që tani janë ndërmarrës të suksesshëm. Një ndër ta është Florian Piraj, që ka kryer në UBT studimet në drejtimin Menaxhim i Mekatronikës dhe Inxhinieri. Ai tha se falë UBT-së dhe kushteve që i janë ofruar, ai sot është një ndërmarrës i ri, që ka krijuar një kompani, që është kompania e parë e llojit të tillë në Kosovë dhe në rajon që prodhon printerë personale 3D.

Edhe Bujar Statovci, që ka studiuar në Fakultetin e Arkitekturës, tani ka një zyrë për krijimin e ideve të reja në ndërmarrësi. Rugëtimi i tij ka nisur me hapjen e inkubatorit të UBT-së në vitin e kaluar, ku është zgjedhur për ide inovative. Ideja e projektit ka qenë krijimi i ndërtesave të lëvizshme, që është produkt inovativ në tregun rajonal. ■

Nga SHBA, libra për UBT-në

Biblioteka Mjekësore dhe e Shkencave të Jetës në UBT pasurohet me 20 mijë libra të rinj

Librat u dhuruan nga kolegë tanë pedagogë dhe studentë nëpër universitete të ndryshme amerikane dhe me kontributin thelbësor të Projektit Ndërkombëtar të Librit në Leksington të shtetit të Kentakit

Biblioteka Mjekësore dhe e Shkencave të Jetës në UBT u pasurua me më shumë se 20 mijë libra të rinj nga Shtetet e Bashkuara. Librat u dhuruan nga kolegë tanë pedagogë dhe studentë nëpër universitete të ndryshme amerikane dhe me kontributin thelbësor të Projektit Ndërkombëtar të Librit në Leksington të shtetit të Kentakit. Nën drejtimin e dekanes së Shkollës së Infermierisë së Universitetit të Floridës së Veriut, Dr. Linda Konelli (Linda Conelly), Shoqata e Studentëve të Infermierisë të Universitetit të Floridës së Veriut (ShSI UFV) dëshironte të bëhej pjesë e këtij projekti duke mbledhur sa më shumë libra universitarë që të mundej për t'ia dërguar UBT-së në Kosovë që ky të hapë librarinë e vet të parë të programit të infermierisë. ShSI UFV-ja ia doli të mblidhte më shumë se 1000 libra në vjeshtë të vitit 2015 dhe i nisi ata në Kosovë nëpërmjet Projektit Ndërkombëtar të Librit.

UBT-ja i mori librat dhe UFV-ja planifikon ta vazhdojë këtë partneritet duke mbledhur libra të tjerë këtë pranverë për t'i nisur ata në Kosovë përpara 1 majit. Kjo përvojë ishte nxitëse dhe prekëse, duke na kujtuar se sa mirënjohës duhet të jemi. Në një letër dërguar UBT-së, studentët nga Florida thanë se shpresonin të kishin luajtur “një rol të vogël në ndihmën për të hapur një program të ri infermierie, duke inkurajuar kështu një ndjenjë globale të bashkësisë në fushën e kujdesit shëndetësor”.

Studentët dhe pedagogët thanë:

Aleks Ferose (Alex Feroce): Ishte nder për mua të isha pjesë e një projekti kaq të mrekullueshëm dhe ai më bëri të vlerësoj burimet që ne studentët kemi në dispozicion.

Xhes Stivens (Jess Stephens): U përmbyta nga bujaria dhe mbështetja që ofruan pedagogët e UFV-së përgjatë gjithë procesit. Ishte e mrekullueshme të shihje zhvillimin e projektit qysh prej ditës së parë dhe ndihem i prekur që isha pjesë e këtij viti të parë të dhurimit.

Dr. Linda Konelli (Linda Connelly): Duke zhvilluar projektin ndërkombëtar të librit, shpejt kuptuam se ishim shumë mbrapa me procesin e transportit. Nëpërmjet mirësisë dhe nxitjes së Z. Majkëll Trotter (Michael Trotter), Mbikqyrës për Dërgesat dhe Marrjet në UFV, projekti ynë i dha frytet me lehtësi.

Veronika (Veronica): Për mua, infermiera ndërtohet mbi dhënien dhe duke marrë pjesë në projektin ndërkombëtar të librit, ndjeva se mund të isha në gjendje të jepja në nivel global.

Enxhi Marini (Angie Marini): Unë fillova në pjesën e dytë të projektit, i cili përbëhej nga transportimi dhe grumbullimi i librave prej zyrave të profesorëve, ku ata gjendeshin. Nuk besoj të kem qenë rrethuar ndonjëherë nga kaq shumë libra mjekësorë. Duke ditur që në po i dhuronim ata për një vend në zhvillim ishte shumë prekëse dhe unë mezi pres ta vazhdoj këtë projekt në të ardhmen. ■



Ekspertë kosovarë dhe austriakë diskutojnë për strehimin në Kosovë

Kosova përballet me probleme të theksuara në fushën e strehimit

Konferencën e hapi Prof. Dr. Edmond Hajrizi, rektor i UBT-së, i cili foli për rëndësinë e madhe që ka ky projekt për popullatën, e sidomos për ata me nevojë të banimit. Ndër të tjera, ai theksoi bashkëpunimin që ka UBT me këto organizma si nga Austria po ashtu edhe nga Kosova. “E mira e krejt kësaj është ndërtimi i Kosovës, dhe këtu po bëhet mjaft rreth saj. UBT ka licencën për të certifikuar administratorët për administrimin e objekteve publike kolektive”, tha dr. Hajrizi

Në organizim të UBT-së, Shoqatës austriake-kosovare dhe OJQ për strehim social dhe të drejta pronësore në Kosovë, u mbajt konferenca me titull “Dita austriake-kosovare e strehimit social”, në të cilën, si edhe në të gjitha konferencat e mëparshme, pati referues nga Kosova dhe nga Austria.

Konferencën e hapi Prof. Dr. Edmond Hajrizi, rektor i UBT-së, i cili foli për rëndësinë e madhe që ka ky projekt për popullatën, e sidomos për ata me nevojë të banimit. Ndër të tjera, ai theksoi bashkëpunimin që ka UBT me këto organizma si nga Austria po ashtu edhe nga Kosova. “E mira e krejt kësaj është ndërtimi i Kosovës, dhe këtu po bëhet mjaft rreth saj. UBT ka licencën për të certifikuar administratorët për administrimin e objekteve publike kolektive”, tha Dr. Hajrizi.

Pas tij, fjalën e mori Merita Dalipi, përfaqësuese e Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, e cila po ashtu u përqendrua në rëndësinë e zhvillimit të projektit për banim social. Sipas saj, Kosova ka kaluar procesin e integritimit. “Kemi kaluar procesin e integritimit, por gjendja e banimit social në Kosovë është e rëndë, edhe pse është punuar mjaft edhe në legjislacion”, tha znj. Dalipi.

Murat Hoxha, përfaqësues i gjeodetëve të Kosovës, u përqendrua te prona si aset i rëndësishëm i hipotekimit dhe i zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Wolfgang Amann, profesor i asociuar nga Austria, foli për përvojat austriake të strehimit social, duke paraqitur në formë tabelare edhe angazhimin e shteteve të tjera evropiane. Ai rekomandoi edhe kosovarët se si mund të zhvillojnë këtë aspekt, duke u ndalur te fokusimi te familjet me nevojë. “Austria ka pasur një projekt që i ka zgjatur 20 vjet dhe ka investuar në 12 shtete”, tha ai. Më tej ai u angazhua në rekomandimin se si do të duhej të zhvillohej ky projekt në Kosovë. “Për të pasur sukses do të duhej fokusuar në sasinë e banimit, provizionit, cilësisë së ndërtimit, zhvillimit urban, integrimi social, etj.”, tha z. Amann.

Mentor Hoxha, anëtar i sistemit për pronën kadastrale në Kosovë, u përqendrua në privatësinë pronësore, duke u ndalur te problemet që paraqiten ose janë paraqitur këtu te ne, meqë Kosova është një shtet i ri, dhe, si shtet i ri, normalisht, që përballet me probleme të mëdha në fushën e kadastrës dhe shkeljen e privatësisë së qytetarëve. Problem tjetër, sipas tij, është edhe shitja e pronave më tepër se një herë, si rezultat i mosnjohurive të përkatësisë pronësore. Megjithatë, ai u shpreh optimist, që edhe në vendin tonë do të ndryshojnë gjërat shumë shpejt, pasi që zhvillimi teknologjik e ka bërë të vetën.

“Jemi duke jetuar në një formë të Big Brother-it, ku satelitët na vëzhgojnë gjatë tërë kohës, pastaj është edhe Google Map, që e di saktë se ku jemi e çka posedojmë”, u shpreh z. Hoxha.

Ai theksoi se sfida tjetër për shtetin e ri të Kosovës është liria e informacionit, dhe e cila, do të vazhdojë deri në përfundimin e kornizës ligjore, sepse nuk ka mbikëqyrje efektive për marrjen e masave, në rastet kur privatësia e ndonjë qytetari thyhet. Krejt në fund, ai theksoi se ata janë pro transparencës së të dhënave kadastrale dhe pro modelit austriak.

Përfaqësuesi i OJQ-së, Agron Beka, tregoi se modeli i banimit social e ka historikun e krijimit në Angli dhe që ata janë munduar t’i japim një formë edhe në vendin tonë. Sipas tij, problem për udhëheqësit tanë është se ata nuk e kuptojnë qartë rolin e banimit social, pra, nuk e dinë se një shërbim i tillë, a është ndihmë që i jepet qytetarëve apo obligim ligjor. “Banimi social është i rregulluar me ligj dhe si i tillë është edhe obligim ligjor”, tha z. Beka.



“Kemi kaluar procesin e integritimit, por gjendja e banimit social në Kosovë është e rëndë, edhe pse është punuar mjaft edhe në legjislacion”, tha Merita Dalipi nga Ministria e Planifikimit Hapësinor

Tutje ai sqaroi se qeveria dhe organizatat e ndryshme joqeveritare, prej vitit 2005 deri më 2015 kanë ndërtuar rreth 1460 shtëpi për këtë qëllim, kurse shumica e tyre janë ndërtuar për komunitetin serb, e që janë të zbrazura, sepse ata kanë vendosur të kthehen në Serbi apo edhe vende të tjera.

Ai përmendi edhe një projekt tejet të rëndësishëm, “Streho edhe ti”, qëllimi i të cilit është strehimi i mbi 100 familjeve, që kanë nevojë për strehim gjatë muajve të dimrit. Një projekt të tillë e ka jetësuar OJQ-ja, në bashkëpunim me Kolegjin UBT, bashkatdhetarët, si dhe bizneset private e publike, kurse kryetar i bordit është rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi.

Në kuadër të kësaj konference, fjalim mbajti edhe ekspertja për administrimin e strehimit social, Zana Tabaku. Ajo tha në vitin e kaluar është lansuar sistemi për regjistrimin e personave, që kanë nevojë për strehim, si dhe vendosja e tyre nëpër banesa e shtëpi strehimi. Sistemi përfshin pagesat e qiramarrësve e qiradhënësve, si dhe hartat se ku ndodhen vendet strehuese. Në fund, ajo shprehu edhe gatishmërinë për të sqaruar ecurinë se si funksionon i tërë ky sistem për të interesuarit.

Shkumbin Asllani theksoi se UBT-ja ka themeluar qendrën për studime shkencore, që gjendet në kuadër të Fakultetit Juridik. Ai tregoi në mënyrë të detajuar krijimin e analizës ligjore për legjislacionin ligjor, që ka për qëllim analizimin e ligjeve e mangësive të tyre, dhe kërkoi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ta shqyrtojë përmbajtjen e ligjeve për sa i përket strehimit social. Asllani theksoi se gjatë analizës do të rishikohen çështjet e strehimit social dhe do jepen rekomandime se si mund të rregullohet ky problem nga qeveria.

“Analiza ligjore për legjislacionin pronësor është shumë e rëndësishme, sepse që nga paslufta nuk janë bërë studime dhe rekomandime të këtij niveli“, u shpreh ai.

Konferenca u mbyll me fjalimin e Ramë Hamzës nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, i cili tha se ata janë ndër

shpenzuesit më të mëdhenj të buxhetit të Kosovës, pasi që harxhojnë rreth 18 për qind të buxhetit të Republikës së Kosovës. Tutje, ai sqaroi se ministria ka ngritur disa objekte të strehimit social nëpër qytete të ndryshme dhe për komunitete të ndryshme. “Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është diçka e shenjtë, sepse ka marrë një mision të shenjtë”, tha ai. Ai tregoi se ata janë përgjegjës për ushqimin e familjeve në kushte të vështira, por jo, edhe për strehimin e tyre, sepse, sipas tij, kjo tashmë ka kaluar në kuadër të pushtetit lokal të komunave. Por, edhe përkundër kësaj, ai u shpreh se kjo ministri do të vazhdojë të ndihmojë dhe të japë kontribut në zgjidhjen dhe përballimin e këtij problemi.



Në programin trajnues pesëmuor në Japoni

Studenti i UBT-së, Atdhe Buja u certifikua me titullin CIO

Atdhe Buja, student në UBT në nivelin master, ka marrë pjesë në program trajnues pesëmuor në Japoni dhe ka arritur rezultatin maksimal duke u certifikuar me titullin CIO.

Objektivat e pritura janë realizuar plotësisht nga Atdheu, i cili ka treguar një rezultat maksimal gjatë gjithë kësaj kohe në të gjitha aktivitetet brenda programit.

Trajnimi i ofruar në kuadër të programit zhvillimi i asistencës nga qeveria japoneze dhe i-Learning, në JICA Okinawa International Center të Japonisë ishte një nga programet më unike të studimit.

Atdheu ishte pjesëmarrës në turin e vizitave në institucionet qendrore, kompani në Tokio & Okinawa, që ishte një mundësi shumë e mirë për të njohur më shumë realitetin dhe suksesin e popullit japonez, ku TIK-u është fushë shumë atraktive dhe ka arritur nivelin më të lartë të transformimit dhe qytetarët e këtij vendi përfitojnë përmes përmirësimit të jetesës dhe marrin shërbimet publike të nevojshme për ta.



Suksesi i madh i studentit të UBT-së Atdhe Buja në Japoni

Gjejnë gabime në Youtube, shpërblehen nga Google

Një grup studentësh të cilët përbëhen prej 4 programerëve të ndryshëm, bënë të mundur që të gjejnë gabime të ndryshme në rrjetet gjigante teknologjike.

Kësaj radhe është Leutrim Berisha ai i cili se fundit gjeti gabime në faqen e Youtube e më pas mori shpërblim, (mjete financiare) nga gjiganti Google.

Por kjo nuk është e gjitha, ky i ri kosovar ka arritur që tashmë të futet edhe në Hall of Fame tek kompania Google, transmeton Klan Kosova.

Fatjona Ramadani

Bachelor dhe master në UBT, më është përshtatur shumë

Fatjona Ramadani ka qenë në drejtimin e arkitekturës. Ajo për këtë numër të revistës Alumni ndan disa eksperiencën nga studimet e saj.

“Ngjarje e rëndësishme gjatë studimeve ka qenë koha kur kemi qëndruar në UBT deri në orët e vona me shoqëri për të përfunduar detyra e të përgatiteshim për provime”, pohon Fatjona, e cila thotë se programet e studimeve në UBT janë të avancuara që mund të krahasohen me shtetet perëndimore. Ajo përmend edhe faktin se arritja deri aty ku është tani nuk ka qenë e lehtë, mirëpo me punën dhe ndihmën e stafit dhe profesorëve profesional ajo ka kaluar të gjitha sfidat dhe vështirësitë që ka pasur dhe tani është duke vazhduar në nivelin e studimeve në master në UBT ngase sipas saj i është përshtatur shumë. Fatjona aktualisht është duke punuar në N.P.N. Fatlindi – Ferizaj.

“Puna ime është si arkitekte në këtë firmë. Kjo firmë bën kryesisht punët e vrazhda në objekte të ndryshme, bën edhe finalizimin e shtëpive që i punojmë. Unë si arkitekte bëj edhe monitorimin e punëtorëve gjatë punimeve e që më ndihmon shumë në praktikë”, tha Fatjona Ramadani. ■



Fiona Beqiri

Studentja e UBT-së, pjesë e shumë kompanive dhe zyrave projektuese



Studentja e arkitekturës në UBT, Fiona Beqiri nga njohuritë e fituara në UBT, ka arritur që të bëhet pjesë e shumë kompanive dhe zyrave të ndryshme projektuese në Kosovë. Ajo i ka kryer studimet e nivelit bachelor dhe po vazhdon studimet në master në UBT dhe në të njëjtën kohë është punuar në një zyre projektuese në “VB Studio”.

“Përkushtimi dhe profesionalizmi i profesorëve dhe gjithë stafit të UBT-së, si dhe lëndët atraktive që ligjërohen, kanë një rol të madh në rezultatet e mia të larta në tregun e punës”, tha Beqiri, teksa tregoi se është duke u marrë në mënyrë aktive me dizajnimin e enterierit të disa shtëpive individuale në lagjen “Marigona”.

Ajo tha se vendimi për vazhdimin e studimeve në UBT ishte një hap i madh dhe shumë i rëndësishëm në përmbushjen e ëndrrës së saj që një ditë të bëhej arkitekte. ■

Fistina Bllaca

Studimi në UBT, pjesë e suksesit

Arkitektura është një ndër drejtimet që ka shumë studentë në UBT dhe jo rastësisht ata e zgjedhin që t’i ndjekin studimet e tyre aty. Fistina Bllaca ka qenë studente në UBT në drejtimin e arkitekturës. Ajo për “UBT Alumni” tregon se përse ka zgjedhur që të studioj në UBT.

“Është e natyrshme që kur je e vendosur për shkollimin dhe profesionin që e do, kërkon institucionin më të mirë që e ofron atë shkollim. Kështu unë, pas mbarimit të shkollës së mesme, menjëherë fillova të hulumtoj rreth institucioneve në Kosovë që ofronin studime të Arkitekturës. E kuptova shumë shpejt dhe u sigurova që UBT ishte e para ndër institucionet Kosovare që ofronte studime kualitative dhe mundësi të shumta të studimeve post-diplomike. Në këtë mënyrë vendosa që edhe unë të bëhem pjesë e suksesit dhe të studioj në këtë institucion të arsimit të lartë”, është shprehur Fistina.

Mes tjerash ajo rrëfeu edhe ngjarjet më të rëndësishme gjatë kohës së studimeve që sipas saj është realizimi i 4 projekteve ideore për kampusin inovativ.

Ajo gjithashtu ka qenë aktive në Zyrën e projekteve dhe ka kontribuar në dizajnimin e hapësirës publike për projekte urbane për komuna të ndryshme të Kosovës si dhe ka kontribuar në dizajnimin e projekteve ideore infrastrukturore me të cilat merret kjo zyrë në UBT.

Menjëherë pas studimeve Fistina punon në Byron e Arkitekturës dhe Dizajnit të Enterierit “Motive Architecture Interior” në Gjilan.

“Byroja “Motive Architecture Interior” ka shpallur konkurs për pozicionin Arkitekt me kriteret e caktuara. Unë kam konkurruar duke i dërguar disa prej punimeve të mia të cilat edhe kanë mjaftuar për të parë aftësitë e mia dhe pas një periudhe të shkurtër fitova vendin e punës si arkitekte. Tani vazhdoj të punoj ende në këtë ndërmarrje duke dhënë gjithmonë maksimumin tim si për kreativitet ashtu edhe për punë”, thotë më tutje Fistina, e cila tani është duke vazhduar studimet master pikërisht në UBT.

Ajo në një të ardhme të afërt beson dhe shpreson se do të jetë pjesë e UBT-së.

“Sigurisht që identiteti im në të ardhmen profesionale do të jetë gjithmonë i ndërlidhur me UBT-në. Ne nuk e dimë se çka do të na sjellë e ardhmja nëse nuk punojmë për të ardhmen. Puna në UBT do të ishte një ndër opsionet më të mira të mundshme. Prandaj besoj se në një të ardhme jo shumë të largët të jam edhe pjesë e UBT-së”, përfundoi Fistina. ■



Fiton Zogaj

Udhëtimi studimor në Evropë, një përvojë e paharrueshme

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT?

Zogaj: Interesimi im i kahershëm që të studioja Arkitekturën ishte mjaft i madh, UBT ishte zgjedhja e duhur. Këtu ofrohej një shërbim kualitativ administrator, kushte të mira studimi, marrëdhënie me universitete botërore, bursa të shumta. Planprogrami që ofrohej nga UBT ishte ai që më përmbushte mua!

UBT Alumni: Cilat kanë qenë lëndët e juaja të preferuara?

Zogaj: Në lëmin e Arkitekturës të gjitha lëndët janë të tilla që shfaqin interesim te studentët, sepse kanë të bëjnë me ambientin që na rrethon, gjithçka çka na shohim, prekim dhe ndjejmë, lidhet me Arkitekturën. Për mua lëndët që do të veçoja janë ato që kanë të bëjnë me Histori dhe zhvillim të Arkitekturës, si dhe projektim dhe dizajnim të Objekteve.

UBT Alumni: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?

Zogaj: Si për çdo student edhe për mua periudha e studimeve ka rëndësinë e veçantë, ka mjaft ngjarje që mbesin në kujtimet tona, por unë meqë bej pjesë në lëmin e arkitekturës do ta cekja udhëtimin në vendet e Evropës, eksperiencë për ne shumë e veçantë, sepse kemi pasur mundësinë t'i shohim e t'i vizitojmë vende me histori të vjetër të Arkitekturës, vende të zhvilluara dhe me Arkitekturë moderne etj.

Ky udhëtim përveç që ka përmbushur qëllimin e tij, ishte edhe një kënaqësi e paharruar.

UBT Alumni: Sa keni përfituar nga programet e studimit në UBT?

Zogaj: UBT është vendi që ju ofron mundësi të shumta studentëve të tij, një ndër ta jam edhe unë, përfitues i dyfishtë i bursave studentore, pjesëmarrës në projekte të ndryshme inovative në kuadër të UBT-së.

UBT Alumni: A keni përfituar nga mundësitë që ofron UBT për udhëtime studimore, studime jashtë vendit përmes UBT-së, internship apo forma të tjera të angazhimit?

Zogaj: Përveç udhëtimit nëpër vendet e Evropës, isha pjesëmarrës në kuadër të intershipit (zyrë projektuese) të organizuar nga UBT, në kuadër të grupit "Ambasadorët e UBT-së", të cilët kemi promovuar të gjitha programet e UBT-së tek maturantët.

UBT Alumni: A jeni duke punuar pas studimeve dhe ku?

Zogaj: Pas përfundimit të studimeve baçelor, tani jam në vitin e parë në studimet master.

UBT Alumni: A jeni duke vazhduar studimet?

Zogaj: Studimet master jam duke vazhduar këtu në UBT drejtimi Arkitekturë, jam në përfundim të vitit të parë, jemi mjaft të kënaqur me mënyrën e ligjërimit. Përveç profesorëve vendorë, kemi profesorë që janë ligjërues në universitetet e shteteve evropiane. ■



Fjolla Abazi


UBT më cilësori në Kosovë

Fjolla Abazi, e intervistuar nga redaksia e revistës "Alumni", u shpreh se ka fituar mjaft njohuri dhe se kolegji UBT i ka ndihmuar në përgatitje për punë. Po ashtu ajo tha se gjatë periudhës së studimeve baçelor ka qenë pjesë e intershipit ku edhe ju ka ofruar mundësi të bëjë hulumtime dhe zhvillime të planeve të bizneseve. Arsyet se pse Fjolla kishte zgjedhur UBT-në të fillonte studimet baçelor ishin të shumta e njëra ndër to ishte se UBT cilësohet si kolegji më cilësor në Kosovë.

"Kam dëgjuar se UBT është kolegji më cilësor në Kosovë dhe kam vendosur të vazhdoj studimet në Arkitekturë në UBT" ka thënë Fjolla.

Gjithashtu ajo na tregoi për lëndët e saj të preferuarat e të cilat ishin Studio Dizajn dhe Kreativiteti.

Fjolla tha se tanimë është duke punuar në një zyre projektuese, të cilën e menaxhon ajo me një koleg të saj, e studimet master po ashtu Fjolla po i vazhdon në UBT në drejtimin e Arkitekturës. ■



Leara Stavileci

UBT më ka ofruar intership në shumë kompani

“Gjatë periudhës së studimeve ngjarjet që më kanë lënë përshtypje mund t’i cilësoj ligjëratat nga profesorët e huaj si ajo e Caroline Jager-Klein, punën në terren (Brezovicë dhe Vushtri) dhe vizitat studimore (miniera e gipsit në Dibër dhe zyrat e kompanisë KNAUF)”, është shprehur studentja Leara Stavileci, e cila është e kënaqur nga studimet në UBT, duke përmendur edhe mundësitë që i ka ofruar ky fakultet. Ajo thekson se ka qenë në vizitë në minierën e gipsit që është në Dibër të Maqedonisë dhe ka marrë pjesë edhe në intership.

“Kam qenë në intership njëmuaj në Komunën e Prishtinës e cila ka ofruar këtë intership për studentë të UBT-së dhe pastaj kam punuar dhjetë muaj në Shërbimet publike në zyrën për Regjenerim Urban. Kam marrë pjesë në trajtime dhe në Shkollat Verore që i ka organizuar UBT-ja ku kemi marrë edhe certifikata. Po ashtu në çdo fundvit akademik punimet tona janë shfaqur në ekspozite ku kemi marrë mirënjohje për punimet tona”, theksoi Leara.

Ajo tani është praktikante në byro private të arkitekturës në “MadenGroup”.



Marigona Mahmuti

Programi, profesorët dhe përkushtimi i madh – çelës i suksesit

UBT Alumni: Si keni vendosur te studioni ne UBT?

Mahmuti: Pas përfundimit të shkollës së mesme në vitin 2012 në shkenca natyrore, pas disa rekomandimeve vendosa të studioj në UBT, pasi që është diskutuar si kolegji më i mirë privat. Duke marrë parasysh se gjeneratat që kanë studiuar dhe kanë përfituar shumë nga studimet në UBT, atëherë ishte një arsye më shumë që të vendosi përfundimisht.

Jam pjesë e UBT-së që nga viti 2012 në studime bacheloret në programin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi dhe specializimi në Banka, Financa dhe Kontabilitet. Dhe kam marrë gradën si Bacheloret i Arteve në MBE. Kam vendosur që të vazhdoj studimet master në Departamentin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi.

UBT Alumni: Cilat kanë qenë lëndët e juaja të preferuara?

Mahmuti: Lëndët e preferuara gjatë studimeve kanë qenë Marketing, Menaxhment Financiar dhe Menaxhment Strategjik dhe Ndërmarrësia.

UBT Alumni: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?

Mahmuti: Gjatë periudhës së studimeve në UBT kam marrë pjesë në shumë aktivitete studentore. Në vitin e dytë kam qenë përfaqësuese e grupit studentor ku kam qenë përgjegjëse për raportimin e ankesave që kanë bërë studentët, si dhe informimin për evente të reja që janë organizuar rreth tyre. Në këtë rast jam cilësuar si Student Ambasador.

Po ashtu kam qenë pjesëmarrëse në tri Akademi Verore që janë organizuar nga UBT, të cilat kanë qenë: ”Summer Academy of Innovation” 2015; “Entrepreneurship Academy Program” 2014 dhe “Academy of Banking and Finance” 2013.

UBT Alumni: Sa keni përfituar nga programet e studimit ne UBT?

Mahmuti: Secili program e ka pas atë rëndësinë e vet dhe secili profesor në UBT është munduar që të sjell sa më shumë njohuri tek ne dhe besoj që jemi të përgatitur në një nivel mjaft të lartë dhe të gatshëm për t’i shfaqur të gjitha ato që kemi fituar deri tani.

Gjatë studimeve po ashtu kemi pasur kurse të ndryshme në gjuhë të ndryshme, që kemi pasur mundësi të jemi pjesë e tyre. Po ashtu, trajnime të shumta në zhvillimin e karrierës “Shkathësitë në Komunikim dhe Prezantim.

UBT Alumni: Ju keni treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?

Mahmuti: Përkushtimi i madh është një ndër arsyet kryesore që kam arritur rezultate të mira në përfundim të studimeve. Kam qenë e angazhuar mjaft që t’i arrij të gjitha në kohë, si dhe arsyeja tjetër ka qenë edhe stafi i kualifikuar akademik i UBT-se, të cilët janë munduar ta japin maksimumin për të gjithë studentët, përfshirë edhe mua.

Kushtrim S. Klaiqi

Studimet në UBT të mundësojnë të përfitosh njohuri të shumta

“Pas përfundimit të bachelorit në Universitetin e Prishtinës, sfida tjetër ishte masteri. Nuk ka qenë aspak e vështirë për të vendosur ku të vazhdoj studimet, sepse UBT-ja më ka ofruar kushte shumë të mira me një staf profesional dhe me gamë të gjerë programesh”, thotë Kushtrim Klaiqi.

Duke mos i anashkaluar lëndët e tjera akademike, të preferuarat e tij kanë qenë Menaxhimi i Operacioneve i Avancuar dhe Auditimi dhe Menaxhimi i Riskut.

Ai thotë se gjatë studimeve ka pasur shumë ngjarje që i konsideron të rëndësishme, por e veçon ceremoninë e diplomimit, si përfundimi i një udhëtimi të vështirë dhe njëkohësisht të bukur.

“Gjatë studimeve në UBT kam përfituar shumë njohuri e sidomos gjatë ligjëratave dhe punimeve të ndryshme. Ky përfitim ka ardhur prej bashkëpunimit të ngushtë me profesorët, shumica e të cilëve vijnë nga universitetet evropiane. Po ashtu, temat e ligjëratave kanë qenë bashkëkohore, në hap me zhvillimin e kohës”, thotë Klaiqi.

Meriton Kabashi

Ish-studenti i UBT-së me performancë të lartë në tregun e punës



Ish-studenti i UBT-së në degën e Shkencave kompjuterike, Meriton Kabashi ka arritur që të përshtatet shumë mirë në tregun e punës në Kosovë, duke i mbajtur katër vende të ndryshme pune.

Aktualisht ai është duke punuar si mësimdhënës në Shkollën e Mesme Teknike “Skënder Luarasi” në Suharekë, si trajner e testues i trajnimit të ECDL-së. Kabashi po ashtu merret edhe me menaxhimin dhe implementimin e rrjetit kompjuterik në SHMT “S. Luarasi”, si dhe me menaxhimin dhe implementimin e kamerave të sigurisë nëpër shkolla & institucione të ndryshme në Regjion të Prizrenit.

Ai tha se të gjitha rezultatet e arritura janë si rezultat i punës dhe angazhimit sistematik në fushën të cilën i është përkushtuar, punës grupore dhe profesorëve të cilit sipas tij, ishin shumë komunikues dhe gati për t’u ndihmuar studentëve në çdo kohë.

“Mësimi gjatë gjithë jetës është motoja që secili njeri duhet ta ndjekë për të qenë në hap me kohën dhe me të arriturat e fundit në fushën që studion”, tha Kabashi.

Sipas tij, UBT-ja është vendi më i mirë për të studiuar, sepse ka stafin më të kompletuar në vend, por edhe më gjerë, madje ai përmend profilin dhe të arriturat e rektorit të UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizit si shtytësin më të madh që ai ka vendosur të bëhet pjesë e këtij institucioni të arsimit të lartë. ■

Nazyf Kabashi

Projektet e studentëve të UBT-së mbërrijnë në vendet evropiane

Ish-studenti i arkitekturës në UBT, Nazyf Kabashi falë njohurive dhe përvojës së fituar gjatë studimeve në UBT, ka arritur që projektet e tij t’i realizojë jo vetëm në Kosovë, por edhe në vendet evropiane si Suedi e Zvicër.

Ai tha se nga njohuritë e fituara ka arritur që së bashku me një student tjetër të UBT-së të hap një ndërmarrje ndërtimore projektuese e cila quhet “Creative Studio”, në të cilën ai e mban postin e drejtorit gjeneral dhe arkitektit.

“Tërë sukseset e mia kanë ardhur falë angazhimit maksimal dhe bashkëpunimit me kolegët, por mbi të gjitha, falë profesorëve që ishin shumë të hapur me ne”, tha Kabashi, teksa tregoi se në UBT ka gjetur mundësitë që nuk do t’i gjente në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë.

“Jam bërë pjesë e UBT-së jo vetëm për shkak të kushteve, por edhe për shkak të marrëveshjeve që ka me universitete të ndryshme të botës, prej të cilave mund të përfitojnë studentët përmes bursave, si dhe programeve të shkëmbimit”, shtoi Kabashi. ■



Intervistë: Prof.dr. Ahmad Zargari, përfaqësues i Universitetit amerikan Morehead State University, me seli në Kentucky

Universiteti amerikan ofron mundësi të mëdha për studentët e UBT-së

Prof.dr. Ahmad Zargari është përfaqësues i Universitetit amerikan Morehead State University, me seli në Kentucky, njëherësh dekan në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Sistemit të Informacionit brenda këtij universiteti.



Prof.dr. Ahmad Zargari

UBT News: Ju keni nënshkruar një marrëveshje me rektorin e UBT-së prof. dr. Edmond Hajrizi, sipas së cilës studentët e UBT-së do ta kenë mundësinë për të studiuar për një semestër ose një vit në universitetin tuaj. A mund të na tregoni më tepër për këtë marrëveshje?

Profesori Ahmad: Po. Ne kemi takuar në kampus, në kampusin e Morehead-it dhe atje kemi diskutuar rreth bashkëpunimit mes Universitetit për Biznes dhe Teknologji, këtu në Prishtinë dhe Universitetit Morehead në Kentucky, për shkëmbimin e studentëve, bashkëpunimit në projekte, në projekte kërkimore, i cili do të përfshijë mundësinë e ardhjes së studentëve dhe stafit të UBT-së për të mësuar në Morehead për një semestër dhe ata të Morehead-it do të vinë këtu në UBT. Po ashtu studentët mund të na bashkohen dhe të vazhdojnë studimet e tyre në Kampusin e Morehead-it, si dhe është edhe mundësia e përfitimit të bursave nga studentët tuaj për t'i përfunduar studimet Master në Inxhinieri dhe Teknologji. Po shpresojmë që kjo marrëveshje do ta zgjerojë bashkëpunimin në

nivelin tjetër, niveli i cili përfshin bashkëpunimin në projekte dhe shpresoj që me shoqatën e akreditimit të quajtur ATMAE (Association of Technology, Management, and Applied Engineering), ju do të keni mundësinë që të lidheni për sa i përket programeve të inxhinierisë dhe teknologjisë, kjo agjenci do t'ia ofroj universitetit tuaj mundësinë që të marr pjesë në konferencën e saj, do ta keni mundësinë që të bëni prezantime atje dhe po ashtu edhe të bëni kërkime shkencore që do të publikohen në ditarin e shënimeve të universitetit tonë.

UBT News: Po ashtu, edhe studentët tuaj do të vinë këtu dhe do të studiojnë, a mund të na tregoni se kur do të filloj ky shkëmbim dhe sa studentë do të jenë pjesë e këtij shkëmbimi ?

Profesori Ahmad: Patjetër, ne e kemi planifikuar këtë. Ne e kemi bërë marrëveshjen strategjike për të hapur komunikimin tonë dhe për të hapur bashkëpunimin tonë, për të arritur deri tek logjika e shkëmbimit dhe ne po punojmë në këtë drejtim. Po shpresojmë që në semestrin vjeshtor të vitit 2016 ne do t'i marrim 3,4 ose 5 studentë tuaj për t'i vazhduar studimet Master në universitetin tonë përmes bursave që ata do t'i fitojnë.

UBT News: Së bashku me rektorin prof. dr. Edmond Hajrizi, ju keni shfaqur gatishmërinë për të shkëmbyer edhe staf akademik, në ç'mënyrë do të bëhet kjo?

Profesori Ahmad: Unë kam qenë i nderuar që të takohem me rektorin e UBT-së, dr.Hajrizi dhe të flas me të në lidhje me vizionin e shkëmbimit të bursave akademike, që do të përfshijë kërkime në mes fakulteteve, pastaj mësimet në të dy kampuset, atë të Morehead-it dhe atë të UBT-së, dhe studentët do t'i bashkohen kërkimeve. Ata do t'i publikojnë rezultatet e kërkimeve të tyre dhe më pas do t'i aplikojnë ato. Jemi shumë optimistë që ne mund ta zgjerojmë nivelin e kërkimeve mes studentëve të Morehead-it dhe studentëve të UBT-së.

UBT News: A mund të na tregoni se cilat janë përshtypjet tuaja rreth UBT-së, për stafin e studentët ?

Profesori Ahmad: Unë i kam vizituar klasat tuaja, kam folur me studentët tuaj, kam parë bashkëpunimin dhe çiltërsinë mes presidentit, dekanëve dhe studentëve, dhe universiteti juaj më duket shumë i përparuar. Studentët kanë laboratorë ku ata zgjidhin probleme dhe bëjnë projekte në mekatronikë, elektroteknikë e dizajn dhe kjo do t'i ndihmojë dhe do t'i shpie ata në karriera të suksesshme në teknologjinë e avancuar duke iu referuar produktit, kualitetit e disiplinës. UBT juaj më duket shumë i fokusuar dhe i angazhuar në suksesin e studentëve, dhe kjo është shumë e ngjashme me atë që ne e bëjmë për studentët tanë në kampusin tonë.

UBT News: A mendoni se gjenerata jonë është në rrugën e duhur në nivelin e arsimit?

Profesori Ahmad: Po, vizioni për të ardhmen është misioni strategjik dhe vizioni që e kam parë në praktikë është në rrugën e duhur. Inxhinieria dhe programet teknologjike po lëvizin. Programet e tjera janë apo nuk janë duke ndryshuar shumë, por inxhinieria dhe teknologjia po lëvizin shumë shpejt. Prandaj, teksa ne lëvizim tutje, nevoja e industrisë dhe e kompanive po ndryshon dhe ne duhet t'i ndryshojmë programet tona po ashtu. Unë po e shoh që kjo po ndodh në kampusin tuaj, po e shoh që ju përgatisni studentë për të ardhmen dhe kjo është shumë e rëndësishme dhe kjo është çfarë ne po mundohemi të bëjmë. Realisht, qëllimi i prezantimit tim ka të bëjë me mënyrën se si ne i përgatisim studentët për të ardhmen. Dhe unë e pashë këtë në mekatronikën që studiohet këtu, e pashë që ajo përfshin dhe kombinon elektromekanikën dhe mekanikën e dizajnit dhe është në rrugën e duhur. E pashë që studentët tuaj të shkencave kompjuterike po mësohen të përdorin softuerin dhe harduerin në të njëjtën kohë, kjo i bën ata më të kushtueshëm për tregun. Studentët që vijnë në kampusin tuaj aftësohen dhe mësojnë detajet për zgjidhjen e problemeve e kompanive dhe ata do të jenë shumë të kushtueshëm.

UBT News: Me siguri, studentët tanë duan të dinë më tepër për universitetin tuaj. A mund të na tregoni më tepër në lidhje me atë se kur është themeluar dhe informacione tjera të përgjithshme për të?

Profesori Ahmad: Po. Ne jemi të vendosur në një vend shumë të bukur në shtetin e Kentucky-it, konkretisht në një qytet shumë të sigurt, në Morehead. Ne jemi 60 milje larg Kentucky-ut dhe 90 milje larg nga Ohajo, pra gjendemi në mes të qyteteve të mëdha dhe krenohemi për shumë gjëra. Ne jemi përzgjedhur për 12 vite rresht si një ndër universitetet më të mira të tipit tonë në SHBA. Po ashtu jemi të akredituar nga agjenci të shumta të akreditimit dhe e kemi mbajtur primatin që nga fillimi. Ne po ashtu jemi të specializuar në shumë drejtime, sidomos në ato të inxhinierisë. Studentët tanë i njohin profesorët e tyre dhe profesorët e njohin secilin student të tyre përmes emrit, njësoj sikurse edhe ju. Gjithashtu, universiteti ynë është themeluar më 1887 dhe aktualisht kemi 11 000 studentë që pretendojnë të diplomohen në Bachelor e Master. Pastaj, ne kemi rreth 65 000 studentë të cilët kanë diplomuar prejse është themeluar universiteti dhe ata tash po kontribuojnë në SHBA duke mbajtur pozita të ndryshme, p.sh: disa janë senatorë, disa janë kongresmenë dhe një prej të diplomuarve është president i një kompanie japoneze. Pra, ata po kontribuojnë brenda dhe jashtë vendit.

Programet tona inxhinierike janë të akredituara nga ATMAE, që është një agjenci kombëtare e akreditimit.

Prandaj, për studentët tuaj që do të vinë në universitetin tanë do të jetë një përvojë e mirë sepse ata do të mësojnë për jetën shoqërore dhe për atë inxhinierike. Disa nga studentët tanë ndërkombëtarë që vinë nga Kina, Lindja e Mesme, India apo vendet tjera, e përfundojnë Masterin tek ne dhe pastaj i dërgojmë në universitete të ndryshme, si në atë të Nju Jorkut apo edhe në universitete të tjera për të aplikuar për doktoratë me bursë të plotë që e marrin nga universiteti ynë. Pra, shumica e studentëve ndërkombëtarë që vijnë tek ne e përfundojnë Masterin, marrin grada, si ajo PhD në universitete të tjera, si dhe disa prej tyre shkojnë në kompani të ndryshme ku punojnë si inxhinierë. Prandaj, edhe studentët tuaj janë të mirëseardhur për t'iu bashkuar programit tonë, si dhe ne do t'i njoftojmë studentët tanë për mundësinë e ardhjes këtu. ■

Ligjëratë e hapur në UBT e profesorit amerikan, Ahmad Zargari

Përfaqësuesi i universitetit amerikan, Morehead State University, me seli në Kentucky, Ahmad Zargari - CSTM, Ph.D, njëherësh dekan në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Sistemit të Informacionit brenda këtij universiteti, ka mbajtur të mërkurën një ligjëratë të hapur për studentët e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Shkencave kompjuterike të UBT-së.

Para studentëve pjesëmarrës, që kishin mbushur sallën, profesori Ahmad shpjegoi në mënyrë të detajuar programet që ata i ligjërojnë në universitetin e tyre dhe theksoi rëndësinë që ato kanë për zhvillimin e teknologjisë në SHBA dhe në botë. Ai tha se Morehead State University është një mundësi shumë e mirë për të gjithë studentët, sidomos për të huajt. Zargar, po ashtu, përmendi edhe faktin se studentët e tyre përfitojnë bursa të cilat u ndihmojnë atyre gjatë kohës sa janë pjesë e universitetit. Shtoi se përfitime të tilla do të kenë edhe studentët e UBT-së, të cilët do të jenë përfitues të programit të shkëmbimit.

“Universiteti ynë ka programe të ngjashme me këto në UBT, prandaj bashkëpunimi do të jetë shumë më i lehtë”, u shpreh ndër të tjera ai.


Profesori Ahmad tregoi se klasat e tyre janë të organizuara në grupe të vogla, me nga 18 studentë dhe se bashkëpunimi mes profesorëve dhe studentëve është shumë i ngushtë, njësoj sikurse edhe në UBT.

Universiteti i Morehead-it ka bashkëpunim me universitete nga vende të ndryshme të botës, si: Kina, Koreja Jugore, Franca, Gjermania dhe së fundi edhe Kosova.

“Studentët tanë marrin përvojë dhe njohuri të mëdha në fushën e inxhinierisë e teknologjisë, dhe kur të kthehen në vendet e tyre janë të gatshëm për tregun e punës”, theksoi Zargar.

Ligjëratën, bashkë me një pjesë të stafit akademik, e përcolli edhe rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi. Hajrizi u shpreh shumë i kënaqur me bashkëpunimin midis dy universiteteve dhe tha se mundësia e ofruar do të shfrytëzohet nga studentët e UBT-së. Rektori shfaqti shpresën se studentët e UBT-së që do të dërgohen atje, do të arrijnë sukses të madh dhe do të kthehen me përvoja e njohuri të reja.

“Qëllimi i universitetit tonë është që studentët tanë të arrijnë sa më tepër suksese, teksa ky bashkëpunim ka hapur rrugë suksesesh”, përfundoi ai. ■



“Morehead State University është një mundësi shumë e mirë për të gjithë studentët, sidomos për të huajt”, tha profesori Ahmad Zargari

Flasin studentët e dalluar të UBT-së

Studentët: Studimi në UBT është privilegj

Studentët e dalluar shprehen kënaqësitë lidhur me kushtet të cilat ofrohen në UBT, duke bërë të ditur edhe synimet e tyre për të ardhmen që shpie drejt suksesit.

Sherife Sokoli

Studentët e UBT-së me punën e vazhdueshme dhe interesimin që shprehin, gjithnjë e më shumë po dëshmojnë vlerat e tyre në profesionet për të cilat janë përcaktuar. Rezultati i këtyre sukseseve vjen nga një staf i shkëlqyer, profesorë të diplomuar brenda dhe jashtë vendit dhe një kuadro i mjaftueshëm studimi.

Pra, secili drejtim në UBT ka studentë të cilët janë pasqyrë e punës së vazhdueshme dhe të palodhshme.

Në bashkëbisedim me disa studentë të dalluar në drejtimet që i vijnë, shprehen kënaqësitë lidhur me kushtet të cilat ofrohen në UBT, duke bërë të ditur edhe synimet e tyre për të ardhmen që shpie drejt suksesit.

Besart Troshupa, si një absolvent i drejtimit Media dhe Komunikim, theksoi vlerësimin e tij si student për kolegjin në të cilin studion duke u shprehur mjaft i kënaqur me kushtet që ofrohen.

“Kolegji UBT, si institucion i lartë i arsimit në Kosovë është vërtet një top kolegji ku dhe studentët më të mirë bashkohen në të njëjtin vend për të mbledhur forcat dhe vazhduar drejt suksesit, e gjithë kjo falë angazhimit të profesorëve dhe kushteve të mira” u shpreh Troshupa.

Lidhur me kushtet e ofruara u shpreh edhe Dorian Gjota student i drejtimit Sistemet e Informacionit. Sipas tij, suksesi arrihet vetëm me punë dhe angazhim, duke mos lënë pa përmendur edhe mundin e profesorëve që për studentët është shtytje shumë e rëndësishme.

“Rrugëtimi im deri këtu ku jam është në mënyrën e duhur, sepse me angazhim të madh kam arritur që të kem sukses dhe do të vazhdoj më tutje derisa t’i përfundoj studimet, me një staf të mrekullueshëm profesorësh”, tha ai. Kujtesa Mehmeti, studente e drejtimit Sistemet e Informacionit, tregon eksperiencën e saj duke vlerësuar arritjet e saja të deritanishme, si edhe mundësitë që i janë ofruar.

“Rrugëtimi im në UBT deri tani ka shkuar ashtu siç e kam planifikuar, madje dhe më mirë. Me mundësitë që më janë ofruar mënyra për t’iu qasur materialeve studimore nga Moodle, ndihma nga profesorët dhe nga stafi në përgjithësi bëjnë që kushtet e studimeve të jenë shumë të mira”, theksoi Mehmeti.

Reisa Imami studente e drejtimit Shkenca Juridike flet rreth synimeve të saj dhe qasjes profesionale ndaj profesionit.

“Synimi im primar është që t’i jap kontribut maksimal vendit tim dhe të ballafaqohem me realitetin që po jetojmë sot. Duke u angazhuar sa i përket çështjeve juridike të cilave shpresoj t’u qasem me shumë profesionalizëm dhe efikasitet”, u shpreh Imami.

Rrona Pula, studente e drejtimit Shkenca Juridike tregon ambiciet e saja që ka në fushën e drejtësisë.

“Vendosa të studioj këtë fushë nga ambiciet e mia të mëdha që të bëhem një femër e suksesshme në fushën e drejtësisë dhe të kontribuoj në ardhmërinë e vendit dhe gjeneratave të reja”, tha ajo.

Studentja tjetër e drejtimit Shkenca Juridike, Arjeta Shala, e cilëson UBT-në si universitet nga i cili dalin njerëzit të suksesshëm.

“UBT-ja cilësohet si njeri ndër institucionet privatet më të mira në Kosovë, nga i cili dalin kuadrot me ngritje profesionale më të mirë në vend”, u shpreh Shala.

Nga ana tjetër, Dren Nishliu, student i drejtimit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, me mjaft entuziazëm tha se qëllimi i tij kryesor është të vazhdojë studimet master jashtë vendit dhe të jetë pjesë e projekteve të mëdha botërore.

“Synimi im është që të vazhdoj studimet master jashtë Kosovës në mënyrë që ta sfidoj veten praktikisht edhe në universitetet me prestigjioze botërore në lëmin e arkitekturës. Dhe gjatë kësaj kohe mendoj që të jem aktiv edhe në projekte të ndryshme, ku vetëm se kam filluar hapat e parë për projekte të mëdha”, theksoi Nishliu.

Benita Sylja, studente e drejtimit MBE, rrëfen eksperiencën e saj si studente duke treguar se me nisjen e studimeve në UBT për të filloi një epokë e re.

“Fillimisht isha studente në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në një universitet tjetër, gjë që më bëri të tërhiqem menjëherë, pasi që kushtet që ofroheshin ishin skajshmërisht negative. Nisa studimet në UBT dhe u ndjeva sikur të kisha lindur për herë të dytë. Çdo gjë më dukej korrekte dhe pozitive, për mua ishte fillimi i një etape të re”, u shpreh Sylja.

Rilind Beqaj studentë i drejtimit MBE gjatë bashkëbisedimit tha se struktura e organizimit të planprogramit me të cilin punon UBT dhe stafi që posedon e bëjnë të dallohet nga institucionet e tjera të arsimit të lartë.

“Programi studimor i harmonizuar me praktikat më të mira ndërkombëtare, stafi akademik profesionalisht i përgatitur dhe i përkushtuar në punë, infrastruktura dhe pajisjet moderne për studime, puna në grupe të vogla dhe ajo ekipore. Të gjitha këto fakte e dallojnë UBT sa i përket cilësisë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë”, tha ai.

Kurse Samire Sadiku studente e drejtimit Shkenca Politike, tregon se me t’u regjistruar në UBT koncepti për institucionet private të arsimit të lartë ndryshoi tërësisht.

“Në fillim nuk kam qenë shumë optimiste mbi cilësinë e studimeve që bëhet në një kolegji privat, por me të filluar studimet në UBT, pikëpamjet e mia ndryshuan tërësisht, kjo si rezultat i seriozitetit të profesorëve të ngritur akademikisht”, u shpreh Sadiku. ■



Besart Troshupa



Dorian Gjota



Reisa Imami



Rrona Pula



Arjeta Shala



Dren Nishliu



Benita Sylva



Samire Sadiku



Rilind Beqaj

Qëndresa Gutaj-Hoti**Studentja e arkitekturës, me firmë të vetën projektuese**

Studentja e arkitekturës në nivelin master në UBT, Qëndresa Gutaj-Hoti ka arritur që menjëherë pas përfundimit të studimeve në nivelin baçelor, të hap firmën e vet projektuese në një fshat të Rugovës.

Ajo tha se vitet e studimeve i kanë sjellë asaj shumë ngarkesë dhe stres, por në fund i tërë mundi i është shpëguar.

“Edhe pse tre vitet e studimeve kanë qenë shumë të vështira, sot po e shoh që kanë qenë të nevojshme sepse falë asaj pune të palodhshme jam këtu ku jam sot”, tha Gutaj-Hoti, teksa tregoi që përvojat më të mira për të kanë qenë vizitat e realizuara nëpër kompani e firma të ndryshme brenda dhe jashtë Kosovës.

“Jam bërë pjesë e UBT-së pasi që qysh më herët kisha dëgjuar shumë fjalë të mira për të, prandaj edhe unë e kam zgjedhur më të mirin për vete”, tha Gutaj-Hoti. ■

**Qëndresa Sokoli****UBT ka arritur t’i përmbushë kërkesat e mia për shkollim**

Qëndresa Sokoli ka përfunduar studimet baçelor në UBT, Fakulteti Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, ndërsa tani vazhdo studimet master në të njëjtin drejtim.

“Programet dhe ligjëruesit në UBT kanë qenë shtysa kryesore për t’u regjistruar në UBT. Mendoj që UBT është ndër institucionet e arsimit të lartë më serioze në Kosovë”, thotë ajo. Ajo thotë se studimet në UBT kanë pasur rëndësi në zhvillimin e aftësive të saj si një arkitekte. Ndërsa, pa dashur ta veçojë asnjërin prej lëndëve, pasi të gjitha e kanë pasur rëndësinë e tyre, megjithatë përshtypje më të mëdha i kanë lënë lëndët: Projektim, Studio Dizajn dhe Dizajn i Enterierit etj.

“E gjithë periudha e studimeve ka qenë shumë e veçantë dhe eksperiencë unike. Ndërsa, një ndër përvojat interesante gjatë studimeve ka qenë udhëtimi studimor në Evropë, vizitat në universitetet e ndryshme dhe uorkshopet e zhvilluara gjatë këtyre vizitave”, shton Sokoli.

E sa ka përfituar nga studimet në UBT? “Nga programet e studimit në UBT unë kam përfituar ngritje profesionale dhe kam marrë njohuri të mjaftueshme për ta bërë punën në profesionin e arkitektes. Jam shumë e kënaqur që UBT ka arritur t’i përmbushë kërkesat e mia për shkollim”, shprehet Sokoli, e cila arritjen e rezultateve të mira ia dedikon punës sistematike, vijueshmërisë së rregullt në ligjërata dhe në ushtrime, konsultimeve të rregullta me profesorët dhe asistentët e UBT-së.

“Për të arritur rezultate të mira duhet një punë dhe përkushtim i madh, mirëpo duhet të jemi mirënjohës edhe për të gjithë profesorët dhe asistentët, të cilët na kanë ndihmuar për çdo paqartësi dhe ajo që më ka ndihmuar më së shumti ka qenë pasioni që kam për arkitekturën”, thekson Qëndresa Sokoli, e cila pas diplomimit ka filluar të punojë si arkitekte në një studio projektuese, “Tiki Design”, që është studio projektuese e cila vepron nga viti 2000 në Prishtinë. Në vitet e para Tiki Design është marrë kryesisht me enterier, përderisa tani trajton problemet e arkitekturës dhe enterierit në të njëjtën kohë. ■



Rrezon Sopi

Ish-studenti i UBT-së, arkitekt në MadenGroup

Ish-studenti i arkitekturës në UBT, Rrezon Sopi, ka arritur që menjëherë pas përfundimit të studimeve në nivelin bachelor në UBT, të qaset në tregun e punës.

Sopi deri para pak kohësh ishte pjesë e kompanisë projektuese “MadenGroup”, mirëpo tash ka hequr dorë nga puna për t’iu përkushtuar vetëm studimeve në nivelin master.

Ai tha se sukseset e tij kanë ardhur falë angazhimit të tij sistematik, si dhe ndihmës së madhe të marrë nga profesorët.

“Kam marrë shumë njohuri gjatë studimeve në UBT, të cilat i kam shfrytëzuar gjatë kohës sa kam qenë duke punuar”, tha Sopi, teksa shtoi se përvojë e mirë për të kanë qenë edhe udhëtimet e bëra gjatë kohës së studimeve.

Sopi tha se ka zgjedhur të bëhet pjesë e UBT-së pa asnjë ngurrim, sepse sipas tij, UBT-ja është institucioni më prestigjioz i arsimit të lartë në vend. ■



Shpend Haxhijakupi

Student, këngëtar dhe menaxher i suksesshëm



Shpend Haxhijakupi ish-student në UBT njëherësh edhe këngëtar në grupin Aragona Band, ka studiuar në drejtimin e Mekatronikës dhe në një intervistë për Alumni ai thotë se fillimisht e ka tërhequr qasja serioze e UBT-se si institucion me një drejtim të veçantë siç është Mekatronika.

Por sa ka përfutuar Shpendi nga studimet, tregon vetë ai.

“Nga UBT kam përfutuar mjaft duke marrë parasysh që përveç mësimit teorik kemi pasur edhe laboratorin në Kampusin e UBT-së. Pra, kemi mundur ta gërshetojmë teorinë në praktikë”, thekson ai.

Ai aktualisht, përveç që është anëtar i një grupi muzikor (Aragona Band) për më shumë se 10 vite punon edhe në një institucion arsimor me emrin “Shkolla Digjitale” ku i mëson fëmijët e moshës 7-15 vjeçare në bazat e programimit, punë të cilën Shpendi e bën me vullnet, duke parë zhvillimin e teknologjisë me hapa gjigantë.

“Planprogrami me të cilin funksionon Shkolla Digjitale është i përpiluar nga organizata CODE si dhe Massachusetts Institute of Technology – MIT në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky planprogram i dedikuar për mësimin e fëmijëve i plotëson të gjitha standardet e nevojshme, është inkuadruar si planprogram i rregullt në shkollat fillore të Amerikës dhe Britanisë së Madhe”, thotë Shpendi, i cili potencon se qëllimi kryesor i kësaj shkolle është zhvillimi i gjeneratave të reja në fushën e teknologjisë informative, për t’u avancuar deri në atë pikë që të ndjehen të pavarur në zhvillimin e programeve teknologjike. ■

Shqiprim Mustafa

UBT ofron ndihmë edhe për menaxhim të kompanive

Shqiprim Mustafa ka qenë student në drejtimin e ekonomikut në UBT. Arsyeja pse ai kishte vendosur të jetë pjesë e UBT-së ishin të shumta, ndër to lavdatat për universitetin, planprogrami, ligjvrimi, stafi dhe gjithçka tjetër që krijon dhe e plotëson me të vërtetë një student. Ai pas përfundimit të studimeve bachelor ka hulumtuar edhe për studime master jashtë vendit por tani është i angazhuar në biznesin familjar por mendon që t’i vazhdoj dhe shpreson se do të ketë përkrahje dhe mundësi studimi edhe në UBT.

Porosia e tij për studentët që të arrijnë sukses është që të punojnë shumë nëse dëshirojnë që të tregojnë të arritura. Por, çfarë po bën momentalisht Shqiprimi?

“Pas diplomimit në UBT kam filluar punën si menaxher në kompaninw time prodhuese të lëngjeve Fluidi sh.p.k në Gjilan. Puna si menaxher më ka ndihmuar më shumë të përforcoj drejtimin si menaxher por edhe kam kënaqësinë që të gjitha njohuritë që kam marrë nga UBT t’i ndaj tani me kolegët”, është shprehur Shqiprim Mustafa, i cili është tejet i kënaqur me studimet e tij dhe e thekson faktin se ky institucion i nivelit të lartë të arsimit i ka ndihmuar shumë. ■



Vigan Zeka

Nga UBT në Fakultetin “Politecnico Di Milano”

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT??

Zeka: Për studime në UBT mund të them se nuk ka qenë një zgjidhje e vështirë, pasi kam pasur fatin të kem disa të afërëm që paraprakisht kanë studiuar në këtë institucion dhe kam qenë mjaft i informuar për kurikulat studimore si dhe për stafin akademik.

UBT Alumni: Cilat kanë qenë lëndët e juaja të preferuara?

Zeka: Është vështirë të veçoj ndonjë lëndë, sepse të gjitha kanë rëndësinë e vet. Tani pasi kam përfunduar studimet po bindem çdo ditë e më shumë se çdo informatë e fituar po më jep vetëbesim për të vazhduar me sukses punën në këtë profesion.

UBT Alumni: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?

Zeka: Njëra ndër ngjarjet e shumta mund të them që ka qenë dita e diplomimit më 26 nëntor 2015.

Kjo datë për mua ka një rëndësi të veçantë.

UBT Alumni: Sa keni përfituar nga programet e studimit në UBT?

Zeka: Programet e studimeve në UBT janë me të vërtetë programe të cilat mund t'i krahasojmë lirshëm me ato të universiteteve me repute botërore dhe dituria e fituar na bën konkurrentë të denjë për profesionin e zgjedhur.

UBT Alumni: Ju keni arritur rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?

Zeka: Në arritjen e rezultateve të mia gjatë studimeve një rol vendimtar kanë pasur edhe profesorët në fakultet, pasi që në çdo rast kanë qenë mëse të gatshëm të na ndihmojnë për çdo paqartësi që kam hasur, por nuk mund të mos them që edhe puna e palodhshme me muaj të tërë nuk ka qenë burim i rezultateve të suksesshme.

UBT Alumni: A jeni duke punuar pas studimeve dhe ku?

Zeka: Po. Jam duke punuar tash e një vit në njërin nga byrotë projektuese më të mëdha në qytetin e Pejës. Jam arkitekt në byronë projektuese “Froject Architecture”, ku si staf jemi gjithsej 6 arkitektë, 2 ndërtimtarë dhe një inxhinier i elektros. Aty po ballafaqohem me projekte nga më të ndryshmet, duke filluar nga shtëpitë individuale e deri te institucionet akademike, ku së fundi kemi fituar vendin e parë në një konkurs shtetëror për projektimin e një shkolle fillore.

UBT Alumni: A jeni duke i vazhduar studimet dhe ku?

Zeka: Studimet Master do t'i vazhdoj në njërin nga institucionet më të mëdha dhe më të vjetra botërore. Ky institucion ka afro 40 mijë student dhe rangohet lart në listën e universiteteve më të mira botërore. Kam arritur që edhe unë pas studimeve bachelor në UBT, me njohuritë e fituara, t'i kaloj me sukses kushtet e pranimit dhe të jem pjesë e Fakultetit “Politecnico Di Milano”. Kjo mund të them lirisht që është arritja më e madhe deri tani në jetën time. ■



Vigan Bulliqi

Me punë, vullnet dhe pozitivitet arrihet çdo gjë



Një institucion i arsimit të lartë, që ofron cilësi sa më të lartë të studimit ka qenë kërkesa e Vigan Bulliqit pas përfundimit të gjimnazit. Pas hulumtimit, ai zgjodhi pas asnjë dilemë UBT-në.

Thotë se lëndët e tij të preferuara kanë qenë “ E drejta biznesore” me prof. Emrush Ujkanin, ”Kontabiliteti financiar” me prof. Nazmi Zeqiri dhe “Marketing” me prof. Uragan Alija.

“Nga programet e UBT-së kam përfituar mjaft. Vlen të përmendet praktika të cilën e kam përfunduar në kompaninë “ZEROPOZITIVE”, gjithashtu për një kohë të caktuar kam punuar edhe si agjent doganor”, thotë Bulliqi, i bindur se me punë dhe vullnet dhe pozitivitet arrihet çdo gjë.

Vigani është duke i vazhduar në UBT, në master, drejtimi Politika Publike dhe Menaxhim.

“E zgjedha këtë drejtim për arsye se desha ta sfidoj veten në një drejtim tjetër, i cili lidhet më shumë me politikë publike , administrim dhe ekonomi, një miksi i cili më ka lënë përshtypje pozitive”, thotë Vigan Bulliqi. ■

Zana Prelvukaj

Realizova ëndrrën për t'u bërë arkitekte

Zana Prelvukaj tashmë koordinatore në nivelin bachelor e stafit të departamentit të arkitekturës e dikur vetëm një studente në UBT, ka thënë për revistën “Alumni” se tash është tejet e kënaqur me të gjitha njohuritë që kolegji UBT ia ka ofruar.

“Së pari më lejoni të falënderoj UBT-në, e cila gjithmonë studentit i ofron kushtet më të mira dhe mundësit më të mira për të arritur ëndrrën e një njeriu. Kam filluar si çdo student tjetër me dëshirën për t'u bërë arkitekte, të arriturat m'i mundësuan afërsia e profesorëve dhe asistentëve, kontributi të cilët më përkushtim të madh e dhanë, stimulimi në mënyra të ndryshme, por pa dyshim bën pjesë edhe interesimi dhe vullneti që ndihmuan të jap këtë rezultat” tha Zana.

Gjithashtu ajo me dëshirën më të madhe ndau disa nga ngjarjet e rëndësishme gjatë periudhës së studimeve, e ato ishin pjesëmarrja ne Ekspozitën Tradicionale të Arkitekturës, pjesëmarrja në Summer School të Arkitekturës, intershipi në Zyrën e Projekteve, përzgjedhja si studentja më e mirë për të mbajtur fjalim para gjeneratave të reja në hapjen e vitit akademik.

Zana gjithashtu na tregoi edhe për disa nga lëndët e saj të preferuara gjatë studimeve (Projektim Arkitektonik, Studio Dizajn, Banim, Gjeometri, Perspektive), po ashtu ajo nuk ngurroi që të na tregojë se pse e ka zgjedhur UBT-në si mundësi shkollimi. “Kam dëgjuar rreth studimeve dhe kushteve që ofron UBT, po ashtu kam pasur shoqëri që më kanë sugjeruar që të vazhdoj studimet në UBT në drejtimin Arkitekturë dhe i kam pasur shembull që vendosa të zgjedhi UBT”.

Tashmë studimet master Zana është duke i vazhduar në po të njëjtin universitet dhe po në të njëjtin drejtim. ■



Disa këshilla për të ndihmuar në luftën kundër ndryshimeve klimatike

Nga Sherif Gosalci



Meteorologjia është shkencë që merret me studimin e atmosferës së tokës, aplikimi i së cilës është analiza dhe parashikimi i motit. Deceniet e fundit e sidomos vitet e fundit jemi dëshmitarë për ndryshimet klimatike të shkaktuara nga rritja në nivel global e temperaturës mesatare. Si rrjedhojë pasojat nga ngjarjet (meteorological events) meteorologjike janë gjithnjë e më të theksuara. Jemi dëshmitarë që këto pasoja tanimë kanë sensibilizuar në masë të madhe opinionin e gjerë mbarë botërorë. Në vazhden e këtij sensibilizimi llogaritet edhe Konferenca për Ndryshimet Klimatike e Kombeve të Bashkuara mbajtur në fund të vitit 2015 në Paris-Francë. Konferenca ka negociuar “Marrëveshjen e Parisit” marrëveshje globale në reduktimin e ndryshimeve klimatike.

Përveç zotimeve të qeverive nga konferenca e fundit dhe nga një sërë marrëveshjesh të tjera që janë arritur dekadat e fundit, është shumë e rëndësishme që të ndikohet në rritjen dhe ngritjen e vetëdijes individuale që të ndikojmë dhe kontribuojmë në ngadalësimin apo zvogëlimin e ndikimit të ndryshimeve klimatike.

Mesazhe të tilla vazhdimisht kohëve të fundit janë lëshuar nga mekanizmat që merren me përkujdesjen e mjedisit dhe Organizata Botërore e Meteorologjisë (OBM).

Ka mënyra të thjeshta që ne mund të zvogëlojmë sasinë e energjisë që përdorim çdo ditë. Shumica e energjisë krijohet nga djegia e lëndëve djegëse fosile si nafta dhe benzina. Ky proces liron gazra të tilla si dioksidi i karbonit, i cili mendohet të jetë një faktor negativ i madh në ndryshimet klimatike.

Ne si shoqëri por edhe individualisht mund të ndihmojmë shumë, për të zvogëluar emetimet e këtyre gazrave duke ndjekur këto hapa:

Përmes ecjes apo ngasjes së biçikletës suaj në shkollë, shetitjes apo kryerjes së punëve ditore duke mos përdorur makineritë që aktivizohen me lëndë djegëse. Çdo galon e benzinës apo naftës e djegur liron rreth 9 kg të dioksidit të karbonit në ajër.

Siguroheni që keni fikur dritat kur ju lëshoni dhomën.

Kur është e mundur, zëvendësoni llambat tradicionale me llamba fluoreshente. Këto llamba përdorin më pak energji për të dhënë të njëjtën sasi të dritës.

Tërhiqeni ngarkuesin e telefonit celular nga priza, kur ju nuk jeni duke e përdorur atë. Ngarkuesit e celularëve vazhdojnë të përdorin energjinë për aq kohë sa ata janë të vendosur në prizat elektrike.

Përdorni peshqirët apo ajrin e lirë për të tharë flokët tuaj, në vend të tharësës elektrike.

Prisni derisa të ketë një ngarkesë të plotë të rrobave të pista para se të përdorni makinën larëse. Ajo merr energji për të nxehur ujin, andaj lani rrobat tuaja në ujë të ftohtë ose të vakët kur është e mundshme.

Në verë, lëshoni roletat hijezuese në dritare, për të mbajtur diellin larg nga ngrohja e shtëpisë. Do t’ju kursejë në zvogëlimin e përdorimit të klimatizerit tuaj.

Vishni një triko kur keni ftohtë para se të lëshoni ngrohësen elektrike. P.sh. çdo vit në SHBA, sistemet për ngrohje dhe ftohje, lirojnë më shumë se një gjysmë miliardi ton dioksid karboni në atmosferë.

Përhapni këto veprime nga më lartë! Shpërndani këshillat e kursimit të energjisë me miqtë dhe familjen.



SI TË KONTRIBUOJMË INDIVIDUALISHT QË TË NDIHMOJMË GLOBALISHT

Hapat e cekur më lartë pothuajse për gjithsecilin nga ne, nuk janë të panjohura, problemet nisin me neglizhencën dhe vetëdijesimin e zbatimit të tyre. Është e vërtetë që ne jemi vend i vogël dhe jemi vetëm një pikë në rruzullin tokësor, por mos të harrojmë se tërësitë krijohen nga grimcat, andaj të kontribuojmë në ruajtjen e globit tonë sepse vetëm një e kemi, nesër mund të bëhet vonë. ■

(Autori është Menaxher i Divizionit Meteorologjik në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror)

Fotoreportazh

UBT – Adresa e suksesit





Top Education for Top Students



- 15 vite Lider i Arsimit të Lartë - I vetmi i çertifikuar për ekselencë (EFQM)
- I çertifikuar sipas standardit ISO 9001:2008 për cilësi
- Përfutues për herë të katërt nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS
- Përfutues i Programit për bursa AEP, Albach
- Përfaqëson Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore
- Kampion Evropian në Robotikë
- Kampusi i parë për Shkencë dhe Inovacion

PROGRAMET E AKREDITUARA

- MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI (Bachelori dhe Master)

- Financa, Banka dhe Sigurime
- Kontabilitet, Auditim dhe Tatum
- Manaxhment, Ndërmarrësi dhe Inovacion
- Marketing dhe Shitje
- Biznes ndërkombëtar
- Logjistika dhe Menaxhimi i Prokurimit

- SIKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI (Bachelori dhe Master)

- Shkenca Komputerike dhe Inxhinieri
- Rrjeta dhe Telekomunikacion
- Softuer dhe sisteme Inxhinierie
- Baza e të dhënave dhe Menaxhimi i Informacionit
- Grafikë komputerike dhe Multimedia
- Programim i WEB-it
- Sistemet Inteligjente dhe Robotika
- Sigurimi dhe Siguria e Informacionit

- MENAXHIMENT I MEKATRONIKËS

(Bachelori dhe Master - I vetmi i akredituar në vend)

- Menaxhimi i Mekatronikës
- Dizajimi Industrial i Produktëve
- Sistemet Inteligjente dhe Robotike
- Inxhinieri Biomedicionale
- Inxhinieri Elektrike dhe Elektronike
- Inxhinieri Mekanike dhe e materialeve
- Inxhinieria e Aerounikës

- SISTEMET E INFORMACIONIT (Bachelori dhe Master)

- Sistemet e informacionit për Biznes
- Sistemet e Informacionit - GIS (Geo Information Systems)
- Sistemet e Informacionit të Librave dhe Menaxhimi i Dijes
- Statistika, Përpunimi i të dhënave dhe simulim
- Siguria e Informacionit dhe Privatësia

- ARKITEKTURË DHE

PLANIFIKIM HAPËSINOR (Bachelori dhe Master)

(I vetmi privat i akredituar në vend)

- INXHINIERI NDËRTIMORË (NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURË (Bachelori)

(I vetmi privat i akredituar në vend)

Zgjedh më të mirin ...

... që të bëhesh më i miri!

Come to UBT and Go International...

Koleji UBT - Bartësi privat i Arsimit të Lartë i akredituar nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe i licencuar nga MAS-IT.

REGJISTRIMI

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

- Diploma, dëftesat e notave, certifikata e lindjes, kopja e letërnjoftimit dhe dy fotografi

Gjuha e studimeve: Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze si dhe mundësia e studimit në gjuhë të tjera

Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjëratat të rregullta dhe me korrespondencë, si dhe ofron mundësinë e studimit në distancë.

Për të punësuarit ofrohen ligjëratat pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës

Që sukcesi juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin studentë:

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe çertifikime ndërkombëtare
- Nga një kompjuter gjatë studimeve dhe sistem online
- Licensa falas për software
- 100% Incentivim në kompanitë dhe institucionet me prestigjioze vendore dhe ndërkombëtare
- Libraria me numrin më të madh të titujve dhe qasja online në librat më të mëdha elektronike
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorët bashkëkohorë.
- Trajtime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECAD, Projekt, etj.
- Çertifikime për kontabilitet në bashkëpunim me SCAAK

Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik Bachelori është 1200 €, për nivelin Master është 1500 € me mundësi pagese deri në 12 këste.
- Për të gjithë nxënësit e dalluar UBT ofron përkrahje financiare

UBT ofron zbritje deri në 30% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Droganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentët që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik

PËR UBT:

"UBT është krijuar si një universitet ndërkombëtar, një universitet modern që i përmbush nevojat e një shoqërie dhe vendi demokratik, që në vazhdimësi është duke zhvilluar kapacitetet ekonomike dhe teknologjike."

Edmond Hajrizi, Rectori i UBT-së

"Edukimi është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e bizneseve, që sot veprojnë ndërkombëtarisht, jo vetëm në hapësirën e Europës, por globalisht. UBT ju ofron mundësinë për të arritur qëllimet-objektivat ndërkombëtare"

"Profesorët e këtij universiteti janë më të mirët, dhe mund të shohje që snadimet tuaja në UBT janë më të mirat për të ardhmen tuaj si dhe të vendit tuaj, por edhe për një të ardhme më të mirë të Europës."

Dr. Erhard Busek Special Coordinator for the Stability Pact for SEE

Lagja Kalabria p.n., Prishtinë, Tel:038 541400 Mob:044 541400 Email:info@ubt-uni.net Koha e regjistrimit çdo ditë prej orës 09:00 deri në 17:30

Apliko online: www.ubt-uni.net/apliko ose në qendrat për Informim dhe Regjistrim në Ferizaj, Prizren, Gjiilan